

INTERVISTË ME ADEM GRABVOCIN

Prishtinë | Data: 11 dhe 13 dhjetor 2015

Kohëzgjatja: 209 minuta

Të pranishëm:

1. Adem Grabovci (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Jeta Rexha (Intervistuesja)
4. Noar Sahiti (Kamerë)
5. Shkumbin Hyseni (Asistent i zotit Grabovci)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

[Pjesa në fillim të intervistës është prerë nga video inçizimi: intervistuesja kërkon nga folësi që të tregojë vitin dhe vendin e lindjes, dhe poashtu të flasë për familjen dhe fëmijërinë e tij.]

Adem Grabovci: Unë jam Adem Grabovci. Kom lindë në fshatin Staradran të komunës së Istogut, nga prindërit Ziza dhe Azemi, i rritur... pas moshës pesë vjeçare m'ka vdekë babai si pasojë e torturave të asaj kohe nga pushteti serb. Dhe rritën e kom pasë me nanën, e cila është përkujdesë për mu dhe vëllezërit, të cilët kanë qenë ma t'moshuar, por edhe ata kanë qenë relativisht në moshë shumë të re, kur kanë marrë edhe mbikëqyrjen e familjes. Unë jam rritë dhe jam eduku n'atë fshat. Shkollën fillore e kam kry po ashtu në fshatin e lindjes. Pastaj kem fillu me shkollën e mesme në gjimnazin në Istog, ku e kam përfundu.

Dhe kem fillu jetën studentore, një jetë krejtësisht e re. Po kem pasë ni fat që kem fillu studimet në rrethana krejtësisht të reja, të një fryme lirisht të re. Përveç që ishte vetë kalimi në studime ni fazë krejtësisht e re dhe e veçantë për çdo t'ri, rrethana krejtësisht t'reja, po ishte e veçanta tjetër që edhe kom pasë fat t'jem student në pranverën e madhe të '81-shit, ku edhe fillunë protestat. Në Kosovë filloi të dëgjohet, mund t'themi edhe publikisht, zëri i pakënaqësisë të qytetarëve të Republikës së Kosovës, pra të shqiptarëve, mbi padrejtësitë që u bëheshin në vazhdimësi, që nga paslufta pra. Lirisht mund t'a qujmë edhe ripushtimin e kësaj pjese të tokave tona, të popullit tonë, që për pasojë e dimë t'gjithë se ka pasë represion, dhe pasojat i kanë vujtë të gjithë qytetarët, familjet shqiptare.

Po pjesë e këtyre vuajtjeve ka qenë edhe familja ime që në pasluftë, pas '48-tës, që është e njohur si koha e Infobyrosë, janë marrë shumë shqiptarë të cilët kanë tregu padëgjueshmëri ndaj sistemit apo pushtetit të ri, të ripushtimit. S'bashku me ata njerëz kryengritës ka qenë edhe xhaxhai im i njohur, Bajram Meta, i cili ka pasë fatin si shumë të tjerë të merret dhe t'çohet në kullën të njohur, n'Kullën e Popit. S'bashku me te pastaj kanë qenë baba dhe axha tjetër, por edhe shumë të tjerë.

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vit?

Adem Grabovci: Po, në vitin '49, aty '48-49. Dhe axha ekzekutohet, dhe nuk kem pasë rast familja, e spjegon ma s'mirti nana, që ta shofim familja kufomën, trupin e tina. Dhe në vazhdimësi familja ka qenë në ankth, ka qenë në pritje të kthimit të trupit të tij, dhe n'fund t'fundit të rehabilitohet pak a shumë shpirti, dhe t'qetësohet shpirti i familjes. Megjithate, ne kemi jetu gjatë tërë kohës me këtë dëshirë, apo me këtë andërr të pritjes. Dhe kjo ka qenë pastaj ni... edhe frymëzim thjesht, edukim i yni që Jugosllavia nuk ka mund asnjëherë të jetë – nëse mund ta qujmë në aspektin figurativ – nanë, po gjithmonë është konsideru si pushtues, si dhunues, si keqbërës, si shkelës.

Por kem pasë fat që edhe axha tjetër të jetë i rreshtuar në brigadat shqiptare, pjesëmarrës në luftra, për çka është edhe i dekoruem nga pushteti i Shqipërisë, me dekorata për trimëri dhe vlerat që ka dëshmu gjatë luftës. Po lirisht mund t'them që nana dhe familja i ka përcjellë të gjitha ato vuajtje që ka përjetu edhe familja, por ne i kemi kuptu edhe vuajtjet dhe dhembjet e t'gjitha familjeve që kanë qenë numerikisht të shumta, që kanë pësuar këto dhimbje, kanë pësuar këto vuajtje. Dhe me këtë frymë jemi rritë në vazhdimësi. Jemi eduku që vërtetë t'a dumë vetveten. Edhe paraardhësit e mi ma t'moshumë kanë bo përpjekje të kontribuojnë në këtë drejtim. Por si familje që kem qenë, të shpallur prej kohësh, prej fillimit, si armiq të sistemit, qysh e kanë pasë fatin edhe shumë familje të tjera, normalisht se kem qenë të... shumëçka të kufizuem, apo të përjashtuem.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka ndodhë me babën e jujë?

Adem Grabovci: Baba pas torturave, i spjegonte nana ma shumë dhe anëtarët e tjerë të familjes, i spjegojnë ma s'mirti për t'i kuptu edhe torturat çnjerëzore që iu janë ba shqiptarëve gjatë asaj kohe, qoftë në vitin '48-49, pra pas ripushtimit t'ri, qoftë në aksionin e armëve, që njihet në popullin tonë periudha e Rankoviqit, viti '54-56, e kështu me rradhë. Dhe në '56-ën, zakonisht pastaj janë marrë prapë si familje kuptohet, dhe shumë familje t'tjera që kanë qenë fillimisht të identifikuar nga ish-pushteti si familje armike, ata janë arrestu dhe janë torturu, janë maltretu çnjerëzisht.

Dhe kemi disa raste që kanë mbetë në kujtesën time, kur tregojnë pasi që e kanë marrë për armë babën dhe axhën, i torturojnë n'atë masë, sa që vijnë kur lirohen pothuajse krejtësisht të pandjenja. Dhe mjekimi normalisht në atë kohë dhe në ato rrethana ka qenë shumë ma i vështirë. Mjekësia ka qenë shumë ma e pazhvillume, por kur ke parasysh, kësaj ia shton edhe pjesë tjetër që s'kanë guxu, kanë qenë të privuar nga ajo e drejtë për ndihmë mjekësore, kanë përdorur ato format ma primitive, edhe pshtjelljen në lëkurë të ogçit apo dashit, deles si thuhet, për t'ia shëru plagët.

Erëmirë Krasniqi: A i kanë mbijetu këto tortura?

Adem Grabovci: Po i ka mbijetu këto turtura, po pasojat pastaj ka qenë, është normale, se si shumë t'tjerë që kanë pësuar nga ato pasoja s'kanë mund të shërohen tërësisht. Në vitin '65-66 ai, veç i shfaqet sëmundja dhe ai përfundon, ndërton jetë. Ndërsa axha tjetër për shkak të atyne pasojave, kamën e ka pasë, njanën këmbë të thyme, t'dëmtume, dhe gjatë tërë jetës deri në vdekje, po ashtu ai ka pasë... edhe ka qenë një shejë si t'thushë, që ne na ka përcjellë dhe na ka mbajtur gjithmonë të freskët kujtesën. Sepse si fëmijë, normalisht kureshtja, edhe m'ka interesu edhe mu, edhe të tjerëve, dhe e kem pytë. Dhe nuk ka hezitu, edhe pse në shumë raste kanë ikë, nuk kanë deshtë t'na tregojnë. Po dikur edhe me rritje, me zhvillim, mosha, duke i kuptu gjërat, kem pytë dhe pastaj detyrimisht janë detyru anëtarët e familjes që t'na spjegojnë. Dhe kanë bo mirë që na kanë spjegu për ato që kanë ndodhë, që çka ka pësuar familja. Dhe ato janë... thjesht janë shndërru lirisht, është normale, edhe në... edhe në urrejte ndaj pushtetit, po fatbardhësisht edhe në frymëzim për angazhim.

Po ashtu axha tjetër pastaj, m'kujtohen shumë raste kur na spjegonte për luftrat që ka marrë pjesë, gjatë luftimeve. Spjegonte shumë mirë luftimet në Tivar, edhe në shumë vende tjera, që ato vërtetë na bënin të mburreshim, të krenoheshim. Edhe pse ne na dukej se po na tregon një film. Sepse nuk e kishim përjetu.

Po fatkeqësisht, na takoi fati që edhe ne pastaj t'i përjetojmë ato. Dhe tash unë e shof se fëmijëve t'mi, apo nipave, u duket se u tregoj film. Megjithatë, kjo është realiteti i popullit tonë, i vendit tonë, nëpër t'cilin kem kalu. Dhe janë këto pikërisht përpjekjet e shumta të popullit, lirisht mund t'them edhe si kolektiv. Dhe sado që janë mundu, përpjekjet i dimë të gjithë që kanë qenë maksimale t'mos lejohet edhe të flasim kundër atij sistemi. Kanë ba përpjekje, propaganda ka qenë shumë e zhvillime n'atë kohë.

Dhe Tito i asaj kohe është konsideru si shpëtimtar. Dhe është arritë që në një pjesë t'madhe të qytetarëve, edhe [ndër] shqiptarë, të paraqitet Jugosllavia si shpëtimtare. Të paraqitet thjesht si nanë e jona. Ndërsa është luftu, është punu shumë nga ish-sistemi jugosllav i asaj kohe që t'na armiqësojnë edhe me shtetin shqiptar, se armiku jonë është Shqipëria dhe miku apo nana jonë është Jugosllavia. Prandaj unë këtu, në këtë rast si gjimnazist, gjegjësisht si maturant para përfundimit të gjimnazit, më kujtohet vdekja e Titos. Me disa shokë ne kishim atë ndjenjën, me disa që kishin, po ashtu familjet e tyne që kishin pësua nga ish-sistemi, dhe kishin atë edukatën edhe kundërshtinë si fëmijë, sa mund t'a kem kuptu n'atë kohë.

Po edhe duke iu falenderu disa profesorëve që n'atë kohë si gjimnazista na i dhanë disa tekste: "Lahutën e Malsisë", kurrë s'e harroj prej profesor Sali Kabashit. Dhe kishim atë si frymëzim pastaj, dhe disa libra tjera që vërtetë ishin frymëzim. Kishim pastaj disa gazeta të asaj kohe nga Shqipëria, që ka qenë "Bashkimi", ka qenë "Zëri i Popullit" e tjera, që për ne vetëm gazeta, jo si përmbajtje po edhe si formë, si materie kështu, ishin frymëzim. Po edhe ne i kem lexu me shumë dashamirësi, me shumë andje. Dhe pastaj edhe lejimi i televizionit po ashtu e ka ba t'vetën, që vërtetë ne të kemi një frymëzim dhe të kuptojmë me shpejtësi sa ma të madhe pozitën tonë. Dhe pastaj t'përcaktohen vërtetë edhe mjetet tona të veprimit. Dhe n'kohën kur vdiç Tito...

Erëmirë Krasniqi: A ka vdekë n'81 ky?

Adem Grabovci: N'79-80. Kur vdiç Tito ne u organizum në gjimnaz në sallë t'madhe përcjellja e ceremonialit të varrimit. Ne organizumë ni aksident kështu mrena, për me prishë pak atë. Dhe na qitën n'parapërrjashtim, drejtori i gjimnazit të asaj kohe, dhe morën disa masa ndaj nesh. Dhe është e vërtetë, ka gjithmonë fat n'fatkeqësi, që thuhet. Dhe këto kanë qenë momentet kur pastaj njerëzit jo që janë dekuraju, përkundrazi. Ka qenë ni frymëzim, dhe aty ka qenë tani lidhja jonë n'mes të atyne shokëve. Dhe pothuajse i kem mbajtur tani kontaktet edhe n'kohën e studimeve, dhe deri edhe tash kontaktojmë mes vete, dhe me shumë dashamirësi i diskutojmë shumë çështje.

Erëmirë Krasniqi: Si ka qenë për ju viti '81, a keni marrë pjesë në protestë?

Adem Grabovci: Po viti '81 isha si student dhe normalisht ajo pjesë e... formë nëse mund t'themi kështu, pak a shumë e fillimit të organizimit të veprimit ilegal, ngjarjet e '81-tës ma ato vetëm kanë ngulmu dhe kanë bo kthesën ma t'madhe t'mundshme, që për mu ka qenë revolucion. Dhe për mu aty është fillimi i përfundimit të sundimit të Jugosllavisë, që u ba edhe realitet.

Por ne kem fillu pastaj edhe shumë ngjarje tjera t'i kuptojmë, edhe të hyjmë n'kontakt edhe me grupe tjera pastaj. E kem pasë ideal edhe frymëzim figurën e ndritur të Adem Demaçit, që grupit tij, të bacës Metush, Metush Krasniqit, të Ramadan Shalës, të Nezir Gashit, shumë e shumë t'tjerë që me t'vertetë ata

janë për t'u admiru, se kanë ba kthesën ma t'madhe, qe na sollën edhe '81-tën. Në '81-tën kom marrë pjesë në protesta si ni pjesëmarrës i rëndomtë, por në qytetin e Pejës pastaj kemi arritë suksesshëm të jem edhe në pjesën organizative të atyre protestave, me shumë bashkëmohatarë. Në komunën e Istogut po ashtu.

Erëmirë Krasniqi: Cilat kanë qenë qëllimet politike? Po menoj, rreth çkafit jeni organizu?

Adem Grabovci: Shiqo, s'pari te ne ka ndiku vetë e kaluara. Thjesht përjetimet në familje, ato janë për mu zanafilla e krijimit të mendimit tim, apo të përcaktimit tim. Pastaj është kontakti me kolegë, bashkëmohatarë të kohës. Ma s'shumti koha e studimeve. Në studime pastaj ne kemi fillu të... normalisht fillon faza e pjekurisë, që gjërat pastaj ke muns... t'krijon vetë ambienti kushte, muns m'i kuptu gjërat krejtësisht ndryshe, m'i përpunu ato, m'i diskutu ato. Por gjithsesi edhe m'i vlerësu situatat dhe m'i përcaku mjetet. Dhe normalisht, me shumë bashkëmohatarë t'kohës ne kemi organizu, dhe kërkesa jonë kryesore ka dominu shpallja e pavarësisë, e Republikës së Kosovës. Ka qenë kërkesë dominante që është përcjellë për shumë vite. Në kontinuitet pastaj janë mbajtë protestat.

Në '81-tën e dimë, ka pasu një represion ma i paparë në rininë, qoftë në protestuesit, me vrasje, me burgosje, maltretime, tortura çnjerezore. Por absolutisht, sado që ka ba përpjekje sistemi i kohës që të ndalë këtë vrull, këtë pakënaqësi, përkundrazi, masat që ka ndërmarrë vazhdimisht e kanë rritë dhe e kanë shtu pakënaqësinë, dhe e kanë shpërnda me ni shpejtësi shumë ma t'madhe. Në '82-tën është e vërtetë se kemi qenë ndër organizatorët e protestave, pra të shënimit të përvjetorit. Kemi fillu me bojkotimin e mësimin në fakultete, që është tregu shumë i sukseshëm. Pastaj tek menza e studentëve kemi shku si të ri, n'mënyrë t'organizume kemi blloku derën e menzës së studentëve dhe aty pastaj kanë fillu grumbullimi i studentëve, dhe ka fillu edhe demonstrimi.

Po në vazhdimësi këto, në '82-tën, në '83-tën, në '84-tën, pastaj kemi vazhdu me aksionet nga ma të ndryshmet, me shkruarjen e parullave, shpërndarjen e materialeve të ndryshme propagandistike, që ka qenë "Bashkimi", "Zëri i Kosovës", "Rruga e Lirisë" e shumë gazeta të kohës, përveç atyne që vishin nga Shqipëria qoftë librat...

Erëmirë Krasniqi: Çka kanë qenë parullat?

Adem Grabovci: Po, "Kosova Republikë", të ngjajshme, "Duam t'jetojmë t'libër", e shumë e shumë parulla tjera. Pastaj kemi formu edhe n'mënyrë organizative grupin. Përgjegjësinë nga shokët e kom pasë t'veproj n'regjonin e Pejës, ku është përfshi Istogu, Deçani, Gjakova, dhe disa komuna tjera, zakonisht me t'ritë e regjonit. Dhe ka qenë ni grup i mrekullueshëm, që ndër ta ka qenë tash dëshmori i kombit Xhemajl Fetahi, që ka qenë ni aktivist i dalluar, n'moshë vërtetë ka qenë shumë i ri por ka qenë shumë i pjekur në mendime dhe në veprime.

Më kujtohet, me Xhemajlin dhe me disa shokë të tjerë kur diskutojshim për aksione të ndryshme, kanë qenë shumë entuziast, shumë t'gatshëm. Dhe kur kemi marrë aksionin në nivel t'vendit për shpërndarjen e parullave, shkruarjet e tjera, me Xhemajlin kemi pasë rast të kemi parullë të shkrueme deri dikun në tre qind e sa metra, tre qind e 80 metra të gjatë. Pastaj kemi pasë vënien e një panoje në largpërçuesin Pejë-Deçan,

në rrugë. Që ajo është veç guximi i tepruar i asaj kohe. Pasi që e kem shpërnda, t'nesërmen ne nga kurrështja se si po veprojnë organet e rendit, kemi dalë edhe e kem shiqu se si po veprojnë policia. Konstatimet kanë qenë nga ma t'ndryshmet, thjesht mbinjerëzore. Jepshin, "Kanë mujtë kështu..." se rreziku ka qenë shumë i madh për shkak të zonës që nuk lejonte [vendosjen]... po ne e kem vu atë. Xhemajli ka qenë shumë i guximshëm.

Pastaj s'bashku me Vehbinë, kushërinin e tij Demën, vëllaun e... shumë shokë t'tjerë. Kemi shpërnda materiale që thjesht për n'atë kohë, sot për dikan mund të konsiderohen si të parëndësishme, por lirisht kanë qenë armë të kohës.

Erëmirë Krasniqi: Cilat kanë qenë reagimet prej sistemit?

Adem Grabovci: Sistemi ka qenë, se normalisht kohë t'gjatë s'kanë mund të na zbulojnë. Kem vepru në regjionin e Pejës kah '82-ta, fundi i '81-tës. Në '82-tën-tretën, deri n'fund të '83-tës, n'fillim të '84-tës. Aty edhe jemi zbulu. Jemi arrestu ni numër në Pejë pas vrasjes së Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe arrestimit të Sejdi Veselit, e të tjerëve. Jemi zbulu edhe ne në Pejë, po asnjherë, edhe pse ishin kontaktet, koordinimi i përbashkët, asnjherë s'kanë mund që t'na lidhin në vijë të drejtpërdrejt. Po, duke iu falenderu thjesht qëndrueshmërisë së shokëve, se qëllimi ka qenë që sa ma pak njerëz të arrestohen. Dhe të vazhdoj... qëllimi i jonë në vazhdimësi – edhe gjatë torturave ma çnjerëzore që janë përjetu – ka qenë kontinuiteti i veprimit. Dhe vazhdimisht kanë mbetë njerëz tjerë të cilët e kanë vazhdu punën edhe ma me ngulm, edhe ma guximshëm. Arrestimet kurrë nuk e kanë ulë intensitetin, përkundrazi, veç e kanë rritë.

Por kem pasë edhe ni material në atë kohë që titullohej dhe ka qenë i shpërndarë tek t'gjithë aktivistët ilegalë, "Armiku na ka në dorë për aq sa lejojmë na vetë". Pra ajo nënkuptonte: na ka n'dorë aq sa ne e zbulojmë vetveten, t'themi se, "Gjithnji kem mendu se armiku nuk dinë asgja", që n'realitet ka ditë shumçka (qeshet). Megjithate, edhe n'përballje me tortura që kanë ndodhë çnjerëzore, me mjetet ma të poshttra, lirisht mund t'shprehem, nuk kanë mund asnjherë që aktivitetin tonë t'a ndërpresin në tërësi. Vazhdimisht janë ngritë grupe të reja dhe kanë vazhdu. E mira ka qenë pastaj që edhe në burgje ku kanë qenë të burgosurit politikë, që për dallim prej kohës të mahershme të Metush Krasniqit, të Adem Demaçit, e tjerëve, që kanë qenë numerikisht shumë t'vogël dhe kanë arritë t'i shpërndajnë nga një apo dy në burgje, për shembull në Pozharevc, Nishë, në burgjet ma famëkeqe, ku kanë qenë numerikisht shumë t'pakët, apo vetëm nga një, dhe s'kanë pasë as me kend të komunikojnë. Dhe ajo ka qenë shumë ma e vështirë.

Ndërsa në kohën tonë kur jemi arrestu pas '81-tës, s'ka pasë burg që nuk ka pasë 20-30 apo 60, edhe ma tepër, vetëm t'burgosun politikë, që lirisht pjesa dërrmuese ka ba edhe mrena burgut ni jetë të organizume. Ka bo ni rezistencë.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet iu kanë burgosë, edhe çka ka qenë verdikti i gjyqit? Për çfarë arsye, qysh e kanë arsyetu mbajtjen në burg?

Adem Grabovci: Po kanë qenë ligjet e asaj kohe, neni 136, alineja 1 dhe 2, për bashkim, për veprimtari armiqësore dihet. Pastaj neni 114 për rrezikim kundërkushtetues, e tjera, e tjera, kundër rendit

kushtetues, e tjera, që tash mund t' mos na kujtohen. Po ka qenë kjo, thjesht jemi dënu si grup i organizuar. Edhe pse asnjherë nuk kanë mund t'i japin atë, me dëshmitë e bashkëveprimtarëve, sepse asnjeri prej... kanë pasë një qëndrim vërtetë stoik. Kanë qenë pa përjashtim të pathyeshëm. Kanë përdorë torturat ma çnjerëzore, dhe shumicën e herave... bile më kujtohet ni rast, ka qenë shumë i randë, kur kërkohej lidhjet me Prishtinën që i kem.

Apo me... n' rastin ma konkret torturat ma çnjerëzore kanë qenë kur kërkonin të vërtetojnë se ne kemi kontakte të drejtpërdrejta me Nezir Gashin, me Sadri Tafilin, pastaj me Shaban Manin, avokatin e nderuar dhe një veprimtar që u vra pas lufte tragjikisht, që kanë qenë shumë t' randësishëm për me, shumë t' çmuar, shumë t' respektumë. Por nuk e kem pranë asnjherë që kem kontakt, duke iu falemnderu qëndrueshmërisë së Rexhep Kelmendit, Zenel Kadrisë, Musa Hasanit, e shumë t' tjerëve të cilët i kanë ditë kontaktet, po asnjherë nuk kanë tregu.

Me një moment ka qenë shumë interesant, kur ishin arrestu për diçka tjetër, Nezir Gashi dhe Xhemajl Gashi. Dhe i kishin qitë në shëtitore, ku mu UDB-ja më ftoj në lart, po në kohën kur ata shëtisnin. Dhe kur i pashë, vërtetë për një moment jam stepë, jam ndi tepër keq. Se menjherë mendova që ata i paskan arrestu dhe normalisht puna do t' ishte shumë keq. Dhe t' u shku, durtë pas shpine si i ka pasë Nezir Gashi, dhe njëri me përvojë që ishte, veç m' ka kqyrë edhe s' ka folë hiç, veç pa i lëvizë buztë m' ka thanë, "Qëndro i fortë, nuk njihem!" Dhe për mu ka pasë rëndësi vetëm ai sinjal. Dhe të gjithë shokët pastaj e kanë marrë vesh se Neziri është këtu, po ai s' na njëh.

Pjesa e Dytë

Pas rastit të këtij takimit me Nezirin, kom shku në UDB, do t' thotë para punëtorëve të shërbimit sekret të Jugosllavisë të atëherëshme. Kryesisht, fatkeqësisht kanë qenë shqiptarë, shqipfolës, që vërtetë janë sjellë në mënyrën ma t' keqe t' mundshme. Edhe ma keq ndoshta se sa vet serbët që ishin... që asistonin gjatë marrjes në pyetje për të dëshmu normalisht atë besnikërinë ndaj padronit. Dhe m' kanë çu në zyren e Asllan Sllamnikut kryeshef që ishte i asaj kohe, ku kanë qenë edhe Mehmet Loci, Qazim Mazreku, Xheladin Beqiri, dhe shumë të tjerë, dhe disa serbë kuptohet. Dhe m' kanë afër dritares kishe rastësisht, dhe m' thonë, "A e njëf?" Dhe m' përcjellin në mimikë sesi po reagoj. Mirëpo, bana përpjekje, edhe pse i ri, i dijsa pak a shumë qëllimet se... edhe nuk reagoja, nuk dhashë ndonji sinjal që.. dyshues. Dhe pashë që ata e besunë atë. Dhe mas atij momenti, lirisht po them që shumë pak m' kanë pytë për Nezir Gashin. Por ka qenë moment sa ka pasë ndikim ajo. Dhe tendenca ka qenë për me na lidhë, për me dhanë pastaj atë vijën organizative, dhe normalisht aty denimet, sanksionet do t' ishin shumë ma t' randa. Por edhe qëndrimi individual i t' gjithëve ka qenë pa përjashtim, që thjeshtë t' mos japin emra, mos të pranojnë aktivitetin tonë që kishim. E n' saje t' asaj pastaj edhe dënimet kanë qenë shumë ma t' ulëta, gjashtë vjet e poshtë. Por, ka ndiku në këto edhe gjatë procesit të gjykimit e qëndrimit të akuzimit, do t' thotë bashkëveprimtarëve.

Por edhe një moment, që ka qenë shumë për mu, që do t' jetë i paharrushëm asht' kur atë natë... ditë që u takumë me Nezirin, n' mbramje zakonisht e kanë pasë kur na merrshin pas orës gjashtë kur fillonte të terrohej, e dijsim që aty do t' pasojnë pastaj tortura. Se gjatë ditës vetëm bënin përpjekje me mbulu atë

maskën e vet, mos me shkakto zhurmë se kishte lëvizje të njerëzve edhe nëpër zyrat e tyre. Dhe na merr gardiani i burgut me m'dorëzua lartë, i thonë, "Baca Hivzi," edhe ka rëngu nihere kur e ka qitë lartë. Se kishte parasysh disa here kom pasë rast, kur baca Hivzi bashkë me të tjerë Isa, Jaha, Jakupi e shumë të tjerë gardianë që kanë qenë vërtetë, që ju kanë dhimtë, lirisht po them, zemra për gjendjen, për torturat kur na shihshin. Ka pasë pasë rast të m'bartin me qebe nga zyret e UDB-ës edhe të m'çojnë në qelinë e burgut. Pastaj kanë bo përpjekje që të m'lajnë ato me ujë t'ftoftë, me peshkir dhe të m'kthejnë në gjendje normale (buzëqeshë).

Dhe në ni rast, një gardian i burgut, dajë i nanës, që une realisht i kojshive aty i nanës, dhe vjen e kujdeset për mu. Dhe bjen, pas alivanosjes m'vetë, dhe kur filloi ai me m'folë, filloj me reagu në gjuhën e asaj kohe që ka qenë për ne normale. Thjeshtë edhe me akuza e me... Edhe ngadalë, mas pak ditëve m'tregon se kush osht'. Atëherë ai ka luftë ni rol shumë pozitiv, edhe shumë gardianë tjerë na kanë nihmu, edhe komunikimin me shokë e kishim shfrytëzua pastaj dhe kem komunikua me njëri-tjetrin me shokë se çka kem folë, dhe çka s'osht' folë. Dhe aty pastaj ka ndiku shumë që ne t'jemi thjeshtë të pathyeshëm.

Por erdh baca Hivzi në ni rast, kur m'ka çu afër në zyre të shërbimit, të UDB-së të asaj kohe, m'thotë, ofshanë, ma ka qitë dorën, m'ka përqaftu, tha, "Qëndro sikur deri më sot". Dhe aty ka qenë thjeshtë, insistimi me çdo kusht që i kërkoshin edhe kontaktet, lirshmërinë edhe me shokët në Prishtinë, po edhe për Shaban Manin, Sadri Tafilin e shumë tjerë, disa tjerë ma t'vjetër. Dhe ish ajo hamendja, thjeshtë, se t'flas apo mos t'flas. Dhe n'atë moment kur ma ka thanë atë fjalë, për mu ka qenë një fuqizim, forcë e jashtëzakonshme që lirisht edhe me m'pa rrjepë që thotë populli, s'do t'kishin detyru me pranua atë që...

Dhe realisht në atë rast pastaj m'kanë dërgua të alivanosun në burgun e Pejës, në spital ku kom qëndru disa ditë. Dhe pas kthimit t'vetëdijes e pas shërimit, jom kthy në qeli prapë. Po edhe në brug, në spital kom pasë kujdes të jashtëzakonshëm, të shtuar. E pas kthimit disa ditë, do t'thotë në burg, përkeqëzimi i gjendjes i ka detyru të më dërgojnë prapë në spital. Dhe e kishin organizua një ndarje t'veçantë, një zyre që kish qenë. E kishin adaptua do t'thotë enkas për shtrirjen time, dhe i kishin çu edhe policët në spital. Dhe kur hy aty, normalisht m'lidhin për dy anët e krevetit {hapë krahët} sepse drejtori i burgut kur ju kish thanë, m'kish paraqitë si një njeri tepër të rrezikshëm dhe ju kish thanë policëve, "Duhet t'keni kujdes të shtuar. Mos e lidhni për këto kamët e krevetit," që i kishte, "po për pjesën e shtratit. Nëse e lidhni këtu [këmbët e krevetit], ia u then, i qet këto kamët e krevetit në shpinë dhe iu ikë" (qeshë).

Edhe pas disa muhabetëve që i kisha me policët, normalisht filluam me bisedua. Ka qenë Agush Berisha polic, pastaj ka qenë Xekë Gojqi, disa policë tjerë që me t'vertetë kanë pasë një shpirt shumë t'pastërt të shqiptarit dhe kem bisedua me ta shumë gjëra. Fillimisht, normalisht, edhe këta kanë qenë të ndrojtur. Dhe mas ni kohe ma zgjidhën njonën dorë dhe m'lanë vetëm me një. Po kur u largua ai nga ajo dhomë, unë arrita me një dru të hollë e zgjidha prangat që isha i lidhun. Dhe u ula kambëkryq në krevet dhe kur hyni ai, po m'sheh ai, i zgjidhun. Thashë, "Jo veç deshta me t'tregua se këto janë t'pavlefshme. Unë edhe me deshtë me ikë, do të iku, po për mu nuk ka nevojë as Zvicra, as Gjermania, as askush. Për mu ka nevojë Kosova. Këtu kom lindë dhe këtu do t'vdes". Dhe ato shprehje i banë përshtypje, u pa dhe filloi pastaj edhe besimi i ndërsjellë.

N'moment, osht' e vërtetë që ky Agushi m'tha, "Une e kom automatikun, nëse thu se je i gatshëm për me ikë, unë do t'bashkangjitem vetëm të ikim s'bashku". Thashë, "Jo, për ne ka novojë Kosova, dhe kem me mbetë në Kosovë". Pastaj aty u kriju edhe me motrat që ishin në përkujdesje personeli shqiptar, po ka qenë edhe ni mjek serb që ia kom harru emrin, në t'vërtetë shovenist, pa asnji ndjenjë humane. Dhe normalisht me rekomandimin e policisë, për me mshefë gjurmët e veta dhe e paraqet si të helmuar dhe nuk i lexon ato pasojat reale.

Kjo ka qenë ajo pjesa, do t'thotë, në spital u kriju me motrat medicinale. Kishin ndjenja krejtësisht tjera, kisha një përkrahje prej tyre, kisha humbë, kisha pasë gjakderdhje gjatë atyne hetimeve dhe isha dobësu tejmasë. Dhe ka qenë Sabihaja nëse s'e kom harru emrin, një motër ma e moshuar, dhe ikte nga puna dhe shkante blente mushkni t'pulës. M'i bijke si ushqim, se këto ndikojnë dhe e kompenzojnë gjakun, ndikojnë pozitivisht. Pastaj edhe komunikimi ka qenë, Cyma ka qenë, Zenija që vërtetë kanë pasë qëndrime jashtëzakonisht t'mira dhe një përkrahje, dhe kanë ndi një dhimbje kështu.

Erëmirë Krasniqi: N'spitalin e Prishtinës?

Adem Grabvovci: N'spitalin në Pejë. Dhe pas pak dite, Cyma u ngatërru me ato serbet dhe e veshi tash kuq e zi, e manifestonte atë... dhe filloi me u ba problem tash edhe në spital (qeshë). Dhe UDB-a e pa të domosdoshme me m'ikë se u ba rrezik se po shpërndahet. Ato ishin motra medicinale, s'kishin qare, ishin detyru me ardhë m'u përkujdesë për mu. Dhe pas pak dite e ndërprejnë atë qëndrimin e tretmanin në spital dhe më kthynë në burg, n'qeli, n'burg. Aty pastaj ka vazhdu ai tretmani sa kanë leju ato kushte. Por e mira e kësaj ka qenë që hetimet nuk kanë vazhdu me atë shkallën si ma heret. Do t'thotë, je marrë vetëm në pyetje edhe pastaj pas gjashtë muajve ka ardhë procesi gjyqësor.

Po edhe një e veçantë që ka mbetë, nuk do t'harrohet ajo kurrë nga mendja, gjithë ato tortura që i kanë përjetu t'gjithë bashkëveprimtarët, që kanë tregu, kanë qëndru të pathyshëm, asht' që kur brenga... t'gjitha kanë qenë anash, torturat, t'gjitha. Po gjithnji ka qenë dëshira edhe ai shqetësimi i tyne se mos ndonjeni prej shokëve të grupit po pendohet që ishte ofertë e organeve të sigurimit të atëherëshëm, të shërbimit të shtetit... UDB-ës. Që në njifar forme t'na thejnë moralisht dhe deklarimi para trupit gjykues se pendohem për veprimet, atëherë ajo reflektonte negativisht tek t'rijtë. Ky ishte shqetësimi i shokëve.

Bile, kjo ma e theksime ka qenë, pa përjashtim të gjithë, po te Xhemajl Fetahu m'thotë, përmes gardianit thotë, "Kërko t'shkojmë te mjeku, te dentisti, te mjeku i dhomëve në t'njejtën kohë". Edhe na çojnë, e aty kishim mundësi pastaj të takohem {bashkon gishtat dëftues të duarve}. Edhe kur u takumë bisedumë për shumë gjëra, m'pytke edhe çdo gja ishte n'rregull. Thotë, "Po, ne me u pendu s'guxojmë". Thashë, "Ne nuk kem hy m'u pendu, Xhemajl". Edhe m'ka kapë, po m'përqafton tha, "Eh vetëm qetë shqetësim e kom pasë". Thashë, "Kurrë. Ne do t'vazhdojmë tutje".

Prandaj, këtu ka qenë ai frymëzimi, qëndrueshmëria edhe thjeshtë besimi që e kem pasë në të drejtën tonë, me veten tonë. Edhe ajo na ka sjellë pastaj deri këtu. Gjykimi, procesi gjyqësor që osht' mbajtë pas gjashtë muajve në '84-tën dikun në qershor, mos t'flas tash me data t'sakta se m'duket ka fillu me 26 qershor nëse s'gabohem. Dhe ka vazhdu ni javë rresht, po asnji nga të akuzuarit, shokët, nuk ka ndodh që t'thotë se ky e ka bo, unë s'e kom bo po gjithënji çdo njani tentonte të merr përgjegjësinë për veti dhe ta

shfajsojnë njëri-tjetrin. Dhe ajo ishte me t'vërtetë, ishte madhështore. Thjeshtë ajo manifestohej, pastaj në ftyrat e familjes, u hoq ai shqetësimi, pastaj ne kem bisedu me familjarët. Ata e kanë pasë shqetësimin se UDB-a ka shpërnda propagandë se ata jonë t'prishun mes veti, se ata po flasin për njëri-tjetrit, gjë që ishte e kundërta. Dhe ajo u dëshmu pastaj edhe gjatë shqyrtimit kryesor, gjatë procesit. Dhe ma i zëshmi ka qenë Xhemajli kur çohet me çdo kusht me marrë çdo gjë për veti me atë bindjen që t'dënohna une e t'lirohen shokët. Po ajo nuk kishte... s'kishte vlerë (qeshë), sepse të gjitha ishin paraparë, dënimet tona paraprakisht kanë qenë të parapara.

Dhe po, e kishte anën e vet pozitive, po ishte edhe tmerr për shërbimin që kohë pas kohe, edhe mas dënimit, që s'lejohen ato me ligj. Po ligjet dihen sa jonë respektu n'atë kohë, n'atë sistem, n'ato rrethana. E na merrshin n'pytje, na kërcënonin. Bonin përpjekje kur dilshim, ne u përqafojshim me njëri-tjetrin, na përcillshin shumë policë edhe alamet aty u bojke... (qeshë). Po megjithatë, nuk kanë mujtë asnjherë t'vetme me na ndërpre pa u përqafo, pa bisedu me njëri-tjetrin. Dhe kur jonë shqiptu dënimet, do t'thotë asnjë nuk e ka dëgju se kush sa po dënohet, vetëm jemi kthi të gjithë edhe jemi përqafo me njëri-tjetrin. Sepse ne ishim t'bindun, se nëse ne e bojmë këtë veprim ajo do t'jetë goditje, do t'jetë grusht për vet shërbimin, për forcat e policisë të shërbimit të asaj kohe. Por njikohësisht do t'jetë forcë për familjet tona dhe për t'rijtë tjerë, dhe do t'jetë frymëzim për t'rijtë për t'vazhdu rrugën, gjë që ajo ka ndodhë kështu.

Erëmirë Kransiqi: Sa vjet keni qëndru në burg, sa jeni dënu?

Adem Grabovci: Ne... Xhemajli osht' dënu për... me gjashtë vite, pastaj ne jemi dënu me nga pesë vite. Pesë vite jom dënu unë, Zenel Kadria, Rexhep Kelmendi po ashtu, tash dëshmorë, dhe kështu me rradhë, tri, katër, një, e kështu. E t'gjithë ata shokë që kem punu që nga fillimi, edhe sot kemi mbetë shokë. Kemi mbetë shokë edhe gjatë vujtjes së dënimit. Në burgun e Pejës kemi organizu pastaj, aty kemi shprehë pakënaqësinë tonë me forma të ndryshme, me barikadime, me greva t'urisë, e kështu me rradhë.

Dhe me një moment ishim, kom qenë në një dhomë, i vetëm isha i burgosun politik që tjerët kishin ma tepër edhe t'burgosun tjerë. Dhe m'patën çu n'atë dhomë, pas shtatë mujë qëndrimi, në qeli do t'thotë i vetëm. Në dhomë ku ishin të akuzumë disa të rijtë të tjerë për vepra të ndryshme, por vërtetë kemi pasë një gjuhë t'përbashkët me ta komunikim dhe për ni moment na u barrikadumë. Edhe në atë dhomën ku isha, ishim... ka qenë për vepra t'ndryshme, tre apo katër të tjerë dhe ata m'përkrahën, u solidarizunë me mu edhe m'morrën n'pytje, drejtori i burgut n'prezencën e tjerëve aty si ishte zakon.

Thotë, "Shiqo, Adem Grabovci për padëgjueshmërinë dhe sjelljen e tij" kështu-kështu, "ta jap fjalën se do t'çoj me ni vend ku do ta kesh mall edhe familjen edhe Kosovën" e tjera, tjera. S'kisha çka i thomë tjetër, thashë, "Shiqo zoti drejtor, une i kom pesë vite, çomë ku të dush", po e përdori një shprehje t'asaj kohe, thashë, "Zoti drejtor ku të m'çojsh pesë vite do i mbaj" m'falni n'shprehje, "edhe me bothë në zhileta, edhe kurrë nuk do të dorëzohem, edhe kurrë nuk do të kërkuj mëshirë nga ju". Dhe vërtetë ai e boni t'veten, diku në shtator m'duket, pas asaj greve na shpërndanë t'gjithëve, kryesisht na çunë në burgjet e Serbisë.

Ku ne n'mëngjes na kanë marrë nga Peja, katër apo pesë të dënuar, të grupeve, t'burgosunëve tjerë që nuk ishin të grupit tim, vetëm unë isha prej grupit tim, tre realisht. Nuhi Hadri m'duket ka qenë, ka qenë

Skender Krasniqi dhe s'ëm kujtohet që ka qenë dikush nga Peja, kom harru. Po qëndrimet i kishim edhe pse s'njiheshim, qëndrimet ishin të njejta. Edhe ne n'mëngjes ishin mobilizu me policë, alamet, thu ti se kushedi çka po ndodhë. Ishte formë e presionit psikologjik. Po, fillumë të këndojmë. Dhe ne dulëm nga dhoma duke këndu e s'na bonte përshtypje se ku do t'na çojnë. A do t'na çojnë n'Prishtinë, a n'burg t'Prishtinës, a Sremit a... s'ish me randësi. Po, ne fillumë me këndu edhe kur m'qitën aty m'i lidhën durtë me pranga. T'gjithë i kishin t'veçantë, dy kah dy, me nga ni parë, mu m'i vnuënë dy. Kur po m'kqyrin kta, edhe nisën pastaj me keshë. Po ni parë me Skendën, ni parë me Nuhiun.

Edhe kur kem shku në burgun e Prishtinës, osht' ndalë ajo far kolone e policisë dhe nga burgu ka nxerrë tre t'rijë tjerë që aty për herë t'parë i kom njoftë. Me mu i ka taku fati n'makinë t'jetë Afrim Zhitia. Dhe kur ka hy atëherë ka qenë n'moshë shumë t're Afrimi... edhe kem fillu pastaj komunikimin s'bashku dhe lidhjen me... po ashtu isha me ni palë pranga i kisha edhe m'takojke pastaj, prangat tjera m'duket e kanë hekë pastaj Skendën a Nuhiun, dhe m'kanë lidhë me Afrimin. Dhe, Afrimi fillimisht qëndroi i heshtur, por ne fillumë pastaj prapë, bisedojshin nga pak edhe fillumë me pytë edhe m'u liru, edhe fillumë me këndu t'gjithë, po kangë të kohës, dihet. Dhe, kur kem shku afër rrugës, do t'thotë jemi nisë në drejtim të Podujevës. Kur kem ardhë te fshati i Afrimit, ka kqyrë nihere, tha, "Ky osht' fashti im".

Dhe, tash, t'ri t'asaj kohe, me plot... por me buzëqeshje, me krenari, pa... Afrimit i thashë, "O, së shpejti do t'kthehem Afrim, dhe do t'a vazhdojmë aty ku e kem lanë." Edhe e kemi vazhdu me kangë. Na u ka nalë makina me ndërpre absolutisht, edhe dikur u dorëzuanë policia edhe ata vazhdojshin, dhe ne vazhdumë me kangë. Dhe jemi nalë pastaj, disa i kanë nalë, m'duket në Stremë, në Nish. Ne e kemi vazhdu pastaj në burgun e Pozharevcit, me Afrim Zhitinë, me Ramadan Avdinë, me Ilaz Zhitinë, Nuh Hadri. E të tjerët kanë vazhdu pastaj në burgje të tjera në Smederevë, e ku di une tjetër.

Pastaj, ka fillu krejtësisht ni ambient tjetër. Pas shumë kohe që ishim në izolim, kur hymë në burgun e Pozharevcit, aty osht' burg shumë i madh dhe krejt ambient tjetër. Kur na kanë qitë nga makina dhe na kanë përballë me hapësirën, kemi marrë frymë shlireshëm dhe kemi ndi nifar emocioni tjetër. Dhe edhe pse s'e dijmë se ku jem, na kanë sistemu aty nëpër dhoma t'gjithë, nëpër kthinat veç e veç ku jemi edhe kemi fillu pastaj atë jetën e t'burgosunit, atë jetë t're. Së shpejti kemi marrë kontakt me ish-burgosunit tjerë sa rrinim në atë karantinën që e quajmë. Dhe ka qenë pavijoni numër pesë, pavijoni numër katër afër aty, edhe kemi komunikim me Nezir Myrtën dhe me disa t'burgosun tjerë, dhe e kanë marrë vesh. Neziri kishte qenë i denumë në '81-tën me Hydajet Hysenin dhe grupet e mahershme dhe mësimdhanës i Afrimit, i Ilazit, i Ramadanit, do t'thotë, tash profesori me nxanësata e vet. Dhe ne fillumë meniherë masi e murrëm vesh se paska t'burgosun politik, dhe disa emra që ne veç i njihim. Dhe fillumë aty te ndijmë një çlirim dhe thjeshtë se jemi në një familje.

Erëmirë Krasnsqi: Qyshe mbajshit komunikimin, a keni pasë ndonjë gjuhë të veçantë me të burgosurit e tjerë?

Adem Grabovci: Po... aty na qitshin në oborr, se ka qenë si gjysëm i hapur tretmani. Ka qenë i ndaluar komunikimi po gjithësesi na i kemi shfrytëzuar... ishte, nuk kishim ndoj pengesë, mure, a diçka. Dhe i shfrytëzonim rastet kur nuk kishte policë, ne komunikonim me njëri-tjetrin. Na kanë majtë ni kohë në

karantinë, pastaj na kanë shpërnda nëpër pavijone tjera. Afrimi m' duket ka qenë në pavijonin numër gjashtë. Unë dhe Ilazi dhe Ramadani dhe Nuhiu në pavijonin numër katër. Pra aty pastaj kanë qenë edhe shumë t'burgosun tjerë që krijunë thjeshtë një jetë krejtësisht tjetër. Dhe po edhe organizimi ishte vërtetë tjetër.

Ajo që ne, çdo i burgosur politik që e ka majtë dhe ka bo... thjeshtë që mos ta diktojmë edhe kohën, ta pëballojmë lehtë. Ka qenë edhe komunikimi i mrenshëm, jeta që kem bo, pëpjekjet ta bojmë të organizime, t'i mbrojmë qëndrimet tona, të tregohem të pathyeshëm para... dhe e diskutojmë shpesh, jemi n' durë t' armikut dhe s' duhet të dorëzohemi, dhe vërtetë ajo ka ndodhë. Dhe ni përkushtim e kemi pasë leximin. Ka qenë biblioteka e burgut në Pozharevc që e kem shfrytëzuar maksimalisht.

Erëmirë Krasniqi: Çka keni lexu?

Adem Grabovci: Po ka pasë literaturë të ndryshme. Për çudi, ka pasë libra të cilat kanë qenë të ndaluara jashtë, ndërsa i kem hasë në burgun, në bibliotekën e Pozharevcit. Se aty ka pasë të burgosun edhe ma heret edhe normalisht për me kriju atë bindjen që ka qenë politika e sistemit, për... para bote me u paraqitë që këqyre na sa tolerantë, sa...

Pjesa e Tretë

Sa kem qenë n' atë pjesën e tretmanit, gjysëm të hapun, ku e kemi pasë edhe punën do t' thotë me dalë në fabrikën e... prodhimin e stufave, t'bardha, "Preporod" kanë qenë edhe t' njohur. Edhe jam njoftë në ditën e parë me Fadil Vatën. Dhe ka ardhë, u morrë vesh se ka ardhë ni njeri me çdo kusht duhej me kontakt. Edhe Fadili, se ka qenë shumë kështu... me ni iniciativë, me një... i pari ka ardhë në atë objektin ku ishim sistemi në një repart. E jemi njoftë me to dhe kemi bisedu pastaj edhe me Fadilin, pastaj me Bardhyl Mahmutin, me shumë tjerë që kem bo pastaj një jetë të afërt, thjeshtë ka qenë një frymë familjare. Por qëndrimi jonë ka qenë thjeshtë refuzus ndaj drejtorit t'burgut, ndaj eprorëve, por me gardianët asnjëherë nuk i kemi leju që... i kem pa me atë që thjeshtë ishin punëtorë, si njerëz që janë të detyrur me punu, me kry punën e tyre, dhe janë viktima të sistemit. Por refuzusë ndaj gjithë eprorëve.

Gjatë asaj periudhe e kom pasë ni moment kur kërkunë për me pasë të drejtë t'vizitës, anëtarët e familjes duhej me pasë listën. Edhe nuk kanë pasë të drejtë anëtarët tjerë. Unë isha i fejuar n' atë kohë pasi që kom ra n'burg. Dhe shkova n' konsulltë me gjithë shokët, edukatorët që kanë qenë përgjegjës për pavijonin dhe përmes tij duhej t' shkojnë të gjitha shkresat. Nji kërkesë për me ma mundësu me ardhë n' vizitë e fejuara. Tha, "Duhesh... po ajo bahet, po duhet me ba një lutje." Thashë, "M'fal unë nuk jom ktu as n'kishë as n'xhami tash, edhe nuk lutem para askujt. Deri n'fund... nëse doni me leju mirë, nëse s' doni..." {zgjatë dorën} Edhe ishte qëndrimi im refuzus n' atë moment se ishte, ata e kishin një qëllim me fillu në mënyrë të ngadaltë thyren e dorëzimin tonë. Po ne kishim qëndrim që n'hap t'parë të ndalojmë mos t' vazhdojmë ma tutje. Po kanë pasu pastaj edhe masat.

Menjherë, pas ni kohe, jonë kriju rrethana të tilla që vëmendja ka qenë ma e shtuar ndaj nesh. Jemi konsideru si ekstrem edhe në burg. Dhe në ni moment të caktuar kur Afrimi ka qenë në ni vizitë me familjen e tijna, në atë moment m' duket ka qenë përvjetori i vdekjes së Titos që osht' përcjellë pastaj me përshëndetje me sirena dhe osht' duftë çdo qytetar të ndalet aty ku ka qenë dhe t' bëj nderim. Dhe Afrimi nuk o çu n' kamë aty edhe osht' konfrontu me gardianin dhe e kanë çu menihere në vetmi. Pastaj edhe Fetah Shemsiun dhe dikush tjetër prej... tash s'ëm kujtohet me emër. Por unë isha n' atë rast në pavijon tu shëtitë me Taip Zekën, edhe tash kur ra sirena, baca Taip, vllau i Kadri Zekës, baca Taip po m' thotë, "Adem Baca, çka po bojmë, a pe nderojmë Titon?" (qeshë) Thashë, "Po qysh t' dushë baca Taip po ia bojmë edhe ne po vazhdojmë tu bo shaka me njoni-tjetrin, t' gjithë t' burgosunit u nalën. Metëm vetëm unë me bacën Taip po lëvizim, pa asnji shqetësim, asnji brengë. Ka qenë njëfarë Gërshtaku guardian, filloi me bërtitë, po na e kishim tonën, s' na shqetësojke.

Të gjithë të burgosnit na shiqonin me habi pse na s' po na lem. Po neve e banëm ate me vetëdije n' shejë të protestimit dhe refuzimit, normalisht. Por organet e burgut, ne e pritshim që do t' marrin menihere masa, po masat s' pari u morrën ndaj Afrimit, Fetahit, të tjerë, ku i dërgunë në vetmi, në qeli, në burg nëse mund t' quhet kështu. Se ka qenë në tretmanin gjysëm të hapun, ku kem pasë t' drejtë t' lëvizjes, do t' thotë me qëndru edhe n' ajr t' pastër. Ka qenë edhe qendra e rekreacionit, një qendër sportive, m' u marrë nga pak me sport si t' gjithë t' burgosnit tjerë që e kanë pasë, po edhe me punu. Do t' thotë, osht' ba edhe një shfrytëzim i të burgosunve për interesat normalisht të shtetit. Dhe pas dërgimit të Afrimit në qeli dhe m' duket edhe Fadili ka qenë, Fadili Vata, ka qenë Fetah Shemsiu. Atëherë, na ni pjesë n' shejë solidarizimi edhe t' protestës, ne kem refuzu punën edhe automatikisht ka pasu masa tjetër edhe për ne, dënimi me qëndrim në vetmi, në ato kthinat që kanë qenë në podrum. Dhe dënimi maksimal ka qenë diku 30 ditë, ndërsa n' atë moment kur na kanë dërgu, kem qenë disa të burgosun që e refuzumë... dhe ishte ma e rrezikshmja që e merrshin organet e burgut, solidarizimi me njanji-tjetrin dhe përpjekja e tyre që ne t' na përqajnë. Po, ne nuk kem leju për asni moment që të përqahe me njani-tjetrin dhe të lejojmë që t' depërtojnë në mesin tonë organet përfaqësuse të burgut.

Dhe pastaj jem denu me nga 90 ditë, do t' thotë tri herë nga 30 ditë qeli. Me disa prej shokëve kemi qëndru në kthinat në podrum, ku pastërtia ka qenë mizerje. Mungesa e ajrit, po ashtu osht' ndi. Kem pasë një dërrasë si ta quaj kështu... që n' mbramje na u lejojke të shtrihem për me fjetë, na jepshin qebe shumë të papastra, batanije. Dhe, n' mëngjes duhej në orën pesë ose gjashtë, të ngrihem nga ajo. E mbyllnim me çelës, andaj ne duhet të qëndronim gjatë tërë ditës aty, vetëm një shkëmb që ka qenë i metalt. Po megjithate edhe ato i kem përballu, dhe i kem përballu mendoj me atë durimin tonë të... thjeshtë, e kem kalu me kangë. Por gjithësesi, kem ba përpjekje edhe gjatë kohës së burgut jom marrë edhe me disa ushtrime kështu, kalitje fizike, nuk i kom ndërpre për asnjë moment.

Pastaj, ka pasu dënimi në izolim që quhej. Ka qenë... lirisht mund të quhet burg në burg. Pavijoni numër shtatë ka qenë vetëm për ata të cilët janë të padëgjushëm, thjeshtë e thejnë rendin shtëpiak të burgut aty. Por ka qenë edhe një metodë tjetër ku na veçonin një t' burgosun shqiptar, e fushin në mesin e tre, katër apo pesë në kthinat e t' burgosunve serbë, dhe ajo ka qenë pjesa, dënimi ma i ranë sepse aty kishte

kriminelë të nacionaliteteve të ndryshme, por kryesisht kanë qenë serbë por që ishin të nxitur nga organet e burgut për t'ba provokime, për thjeshtë, ta rëndu jetën e t'burgosunve.

Sjelljet tona edhe komunikimi nuk ka mungu edhe me t'burgosunit, edhe kem arritë të krijojmë raporte shumë t'mira të komunikimit edhe me t'burgosunit serbë, pavarësisht natyrës se ne s'na ka interesu se kush për çka osht'. Ne i kem pasë qëndrimet tona dhe ne kem pasë interes t'mos kem konflikte, dhe nuk kem leju, nuk kem pasë, përveç ni rast të vetëm që një nga shokët ka pasë ni konflikt ku u sulmu Bajrush Xhemajli nga ni kriminel i njohur i dënumë që ka qenë dikun njizet vjet me sa m'duket, për vrasje. Edhe në atë pavijon, në shtatësh, nuk ke pasë t'lejumë as me pasë, asgja t'metalit te vetja, se ka qenë burg thjeshtë sikur burgjet hetimore... dhe s'lejohej asnjë gjësend i metaltë. Ndërsa, serbve u lejoheshin edhe u jipeshin nga vet organet e burgut për t'na provoku dhe për t'na sulmu. Në këtë rast lejohet edhe zhiletë ku tenton ta dëmtojë Bajrushin, pastaj ka reagu Bardhyl Mahmuti dhe i ka dalë në ndihmë dhe e godasin atë kriminelin dhe aty u kriju një situatë tepër e randë.

Ne ishim të mbyllur dhe dyert sado që tentonim edhe m'i thy dyert sepse ishte e tmerrshme, ne e dijsim se si shokët tonë janë duke u përleshë me dikun, dhe ishim t'bindun se diçka shumë e keqe po ndodhë. Dhe ishim të shqetësuar për fatin, se mund të humbte jetën ndonjë nga shokët, por ajo fatbardhësisht përfundoi me aq. Pastaj pasunë me masa që Bardhylin e disa prej shokëve i shpërndanë në burgje tjera. Dhe ne pastaj kemi mbetën në burgun e Pozharevcit që kemi refuzu shëtitjen. Dhe kemi qëndru dikun rreth tri viteve në kthina, në dhomat e izolimit pa dalë fare në shëtitje, sepse në ni periudhë kohore kem pasë të drejtë 30 min në ditë të dalim n'ajr t'pastër, por kem qenë t'obliguëm t'i majmë kapelat, uniformën e t'burgosunit, të mbërthyera, taman ashtu si ushtarë dhe durtë pas shpine t'i qesim, dhe t'sillem tridhjetë minuta.

Dhe ne pastaj bamë edhe ni kërkesë tjetër, që t'na lejohet shëtitja e lirë pra me qëndru tridhjetë minuta ma gjatë, po me pasë t'drejtë pa xhaketa, pa kapelën dhe thjeshtë me lëvizë shlireshëm. Dhe krejt kjo na u refuzu nga drejtoria dhe ne pastaj në shejë proteste e bojkutumë në tërësi dhe kem qëndru dikun rreth tri vite pa dalë asnjë minutë në ajr të pastër, vetëm vizitat që i kem pasë të familjeve çdo mujë, ato kanë qenë një ndihmesë shumë e madhe e jona që na bijshin ushqime. I kem pasë të përcaktuara n'peshë katër kilogramë, po edhe çka kanë qenë të përcaktuara, çka mund të sjellin.

Kem arritë që t'i programojmë vizitat e familjeve që mos t'na vijjnë t'gjithë njëherësh, por dikush n'fillim, dikush n'mes, dikush kah fundi. Dhe tre apo katër që ishin në dhomë, me pasë ushqim të mjaftushëm gjatë tërë kohës. Dhe njikohësisht, familjet na furnizonin edhe me literaturë, me libra nga ma të ndryshmit. Dhe ka qenë shpëtimi jonë që ne kem pasë të programume kohën. Kem pasë orar, kem pasë edhe ni dicitlinë. N'mëngjes kem ba vazhdimisht ushtrime fizike, edhe pse nuk na lejojsin organet e burgut. Megjithatë, ne e shfrytëzonim edhe atë ambient ashtu. Edhe pse ka pasë, zakonisht n'verë, mungesë të ajrit se ka qenë një rrjetë e metaltë në brendi, pastaj ka qenë dy palë xhama t'qelqit dhe rrjeta tjetër në anën e jashtme. Dhe ne zakonisht n'verë, edhe pse ishte e palejshme, ishte e dënushme, ishim t'vetëdijshëm që do t'ndërmerrnin masa, ne n'vazhdimësi e kemi thy qelqin një pjesë. E tërhiqim atë

pjesën e brendshme dhe shpesh gjatë ditës, kur nijshim mungesë t'ajrit, u afronim afër dhe merrnim ajr të mjaftueshëm. Megjithatë, e kemi përballu bashkarisht me t'gjithë shokët.

Pastaj e kemi pasë orarin, pas mëngjesit na vinin, na merrshin dhe e mbaronim punën me lexim gjatë tërë kohës. Dhe e planifikojshim se brenda kësaj dite sa do të lexojmë, dhe n'mbramje pasi fikej drita, kishim koment gjatë asaj, diskutime se çka kishim lexu gjatë ditës. Dhe pas përfundimit të kësaj kemi pasë atë pjesën e folklorit (qeshë). E kem pasë zakonisht m'duket në dhomën numër tetë ku kem qenë s'bashku me Nezir Myrtën dhe Sami Kurteshin. Neziri i binte çiftelisë shumë mirë dhe ne kishim çiftelinë aty, po jo çiftelinë e zakonshme por të improvizuar se... i burgosuni gjindet (buzëqeshë). Dhe n'atë pjesën e qumshtit, atë... e pijshim qumshtin dhe pakon e merrshim e shfrytëzojshim si kokë të çiftelisë, ndërsa këtë bishtin e çiftelisë e maronim me karton, letër të kartonit. E mbshtillnim mirë edhe e bojshim bishtin e çiftelisë, ndërsa telat me rrethikat e qorapëve, i nxirrshim dhe i bojshim telat e çiftelisë. Ndërsa, perdet me këtë pjesën e cellofon, asi të cigareve, mbshtjellësen e cigareve e bojshim si perde dhe Neziri i nxirrte tingujt taman si një çifteli e vërtetë.

Dhe pastaj i fillonim çiftelisë dhe këndonim një kohë, tridhjetë minuta apo derisa na lejonin. N'atë moment si na dëgjonin që po i bijmë pasi fikej drita, menihere u merrshin masa sepse ishte rreptësisht e ndaluar. Zakonisht këto masa ishin ma tepër tek ne, mirëpo ne e bënim tonën dhe ishim t'vetëdijshëm për masat dhe nuk na bënte përshtypje se a do t'dënohem a s'do të dënohem. Për ne ishte ishte një, si qëndrumë n'dhomë, si qëndrumë në qeli, kështu që ishim pajtu. Po edhe organet e burgut, edhe gardianët mo u pajtunë edhe ata. U detyrunë t'pajtohen sepse ne i shihshim me mospërfillje.

Kemi vazhdu kështu me qëndrim në izolim s'bashku me Nezirin. Dhe ajo që pastaj kemi pasë një përplasje me organet e burgut kur në rastin e Paraqinit, vrasja e Aziz Kelmendit dhe arrestimi i disa të burgosunve. Pastaj u vra edhe ni i burgosun që ka qenë për ni vepër tjetër, m'duket Ibrahim Kastrati nëse s'ia kom harru emrin, u vra në burgun e Pozharevcit dhe pastaj u shpallë kinse bani vetëvrasje, që ishte e pavërtetë. Dhe në shejë proteste bani shkresë që kishte akuza që ishin shumë t'rana për drejtorinë e burgut, për sistemin, por që ishin reale për ne. Dhe pastaj në shejë hakmarrje, drejtori i burgut erdh, tha, na boni ni provokim, tha, "Ju e keni bo këtë shkresë, qëndroni?" Thamë, "Po, patjetër qëndrojmë." Po, ne fillumë ende ta rëndojmë atë akuzën tonë edhe të tjera ndaj drejtorisë, sistemit, sjelljeve të tyne të padrejta dhe pasoi pastaj dënimi.

Pas dënimit n'burg, pas kthimit nga qelia, po ashtu pas pak kohe, drejtori kishte organizu, dikun kanë qenë 40 gardianë qysh kemi arritë t'i numrojmë, edukatori, komandanti i burgut e tjerë. Dhe drejtori i burgut na drejtohet në kthinën ku ishim ne me Samiun e Nezirin, tha, "A do t'dilni në shëtitje?" Thamë, "Po, po ne do t'dalim n'shëtitje, të lirë." "Çu dilni!" Atëherë ne e ditëm që na osht' përgatitë diçka. Dhe Samiu ka qenë shumë ma i zhvillumë, po edhe une isha pak ma i shëndetshëm se sa Neziri, dhe shqetësimin tonë e kishim mos pe godasin Nezirin. Dhe e shtimë n'mes Nezirin dhe dulëm në shëtitore. Kur dulëm n'shëtitore, ne nuk e vumë kapelën fare, nuk i mbërthymë kapëset e xhaketës edhe fillunë durtë të lëvizin shlireshëm {lëvizë krahët}.

Drejtori na dha komandë tri here, qysh ishte paraparë, “Durtë pas shpine, durtë pas shpine!” Ne s’ndëgjumë. U dha urdhër gardianëve që t’na sulmojnë dhe ne në mënyrë instinktive jemi kthy nga ana e murit, me shpinë nga muri, dhe e kem përgatitë me Saminë dhe e kem shti n’mes Nezirin. Për fat tonin, mirëpo edhe të tyne, ata nuk u afrunë t’na sulmojnë fizikisht. Atëhere dha urdhën që t’hyjmë mrena, na çunë n’vetmi, realisht, në ni diskutim me drejtorin. Edhe kur hymë filloi atëherë me me akuza kundër tij, ai kundër nesh, na çunë n’qeli. Dhe n’qeli na lidhën jo me pranga ato që ishin, po me zingjirë dhe me dry, që do t’thotë ishte luftë psikologjike. Na ndanë në tri qelia dhe jo m’u ulë n’atë ulësen e metalit, po na detyrunë të shtrihem. Dhe ka qenë ni ‘gorrillë’ që i thojshim edhe ni ‘zhvilla’ gardian, na i kërkoshin këtë pjesën këtu {tregon kyqin e dorës} t’na vejnë zingjirët, që mos me leju me lëvizë, tamon mos me leju qarkullimin e gjakut. Edhe ne... shumë mrapshtë qysh ditën ata me randë edhe na lejunë. Mirëpo ne fillumë meniherë me këndu, edhe s’e harroj kurrë, “Në Dardani bjen ni tupan,” kem fillu me Sami Kurteshin me kokë i kem mshu murit edhe i kem dhanë shejë.

Tash unë nuk e dijsa a osht’ Samia, a osht’ Neziri. Mirëpo, aty kish qenë Samiu, meniherë fqj me mu, ndërsa përballë kish qenë Neziri, dhe ne fillojmë me këndu me fishkëllimë. Dhe e përcjellnim nga dritarja, ndëgjohej fishkëllima e njëri tjetrit edhe kem vazhdu kështu. Kur pas pak kohe ka ardhë mjeku në burg. Ajo ishte për efekte psikologjike, thjeshtë. Edhe po hyn me gardianët, tha, “Çka po ban?” M’shihke t’shtrimë, t’lidhun. Thashë, “Po knoj,” tha, “Si?” m’u drejtu “Kako?” Ju kom kthy n’serbisht, thashë, “Pjevam!” [“Po kendoj!”] (buzëqeshë). Veç u tmerru, ai ishte, ishte e papritun diçka për to edhe n’atë gjendje do t’thotë, se ai kish ardhë për t’na thy neve psikikisht. Dhe ai e pësoi, e murrë atë që e meritoi.

Po t’njejtën gja, pa u marrë vesh ne e ka hasë te Samiu, t’njejtën gja te Neziri. Dhe ashtu na kanë majtë një kohë, kem hy n’grevë, e kem refuzu ushqimin, t’gjitha. Na kanë nxjerrë pastaj pas një kohe. Një ditë... m’duket ditën e tretë dhe na kanë çu n’repart të drejtorit. Dhe n’këtë rast, pas tri dite kur kem qëndru n’grevë, na kanë ftu n’repart siç ka qenë rregull. Dhe thjeshtë te drejtori shkova, po hy. Ai ka qenë me t’vërtetë një shovenist që ka marrë pjesë në proceset që kanë qenë, në masakrën që osht’ e njohun n’vitet e ’60-ta, ’70-ta dikun, ka ndodhë në burgun e Pozharevcit dhe ai ka qenë gjyqtar që i ka dënu me vdekje shqiptarët të atij rasti. Dhe m’thotë, unë as s’e përshëndeta, u sillshim se kishim qëndrim t’tillë që t’mos përfillet, do t’thotë të manifestojmë atë revoltën tonë, pakënaqësinë tonë në çdo aspekt dhe n’çdo formë që na ipet rasti.

Dhe m’u drejtu, tha, “Mirë zoti Grabovci, kur do të përshëndetem unë e ti ndonjëherë?” Thashë, “Ne do të përshëndetem,” s’mu kujtu me i thanë përmes thumbit t’pushkës, “ne do të përshëndetem përmes pushkës.” Dhe gardianët reagonë se ishte tash eprori i tyre aty. Tha, “Leje, mos e ngucni, se ai ka t’drejtë, po bohet korrekt. Unë jam armik për to, ai osht’ për mua.” Tha, “Po, tridhjetë ditë je i dënumë n’qeli.” Thashë, “A ki diçka tjetër ma shumë me ba? Edhe këto do t’shkojnë.” Edhe atëhere u nervozu, “Dil jashtë!” M’kanë kapë gardianët me m’çu edhe ka qenë ni gardian i ri, se t’gjithë gardianët i identifikojshim n’bazë t’sjelljeve, i thojshim ‘kokërrsharrë’, hajdut. Edhe ka qenë bukur arrogant kështu, po n’raport me ne ka qenë shumë i kujdesshëm me t’burgosnit politik sepse edhe nuk i jipshim rast. E n’këtë rast m’bani

përshtypje, duke shku, duke zbritë shkallëve në podrum të qelisë, ma bon me dorë kështu {zgjatë dorën}. Unë mendova që po don me m'provoku, me m'goditë edhe jom kthy, kom reagu shumë shpejtë, kur ma ka bo "Neka, neka!" Mo, mo, tha, "Nal, veç po du me t'vetë diçka." Thashë, "Urrno?" M'ra ni rast t'mirë, mu shprehë, ni lloj propagande edhe n'ato kushte (buzëqeshë). M'thotë, "A bon, e kom diçka t'paqartë. Pse ju po silleni shumë mirë me ne gardianët dhe nuk e kem asnjë problem me ju t'burgosnit politik shqiptarë? Ndërsa me drejtorin, komandantin, edukatorin..." Thashë, "Po shiqo, ti je i burgosun sikurse unë. Ti je i detyrumë me ardhë këtu për shkak se mbanë familje. Prandaj, ne t'trajtojmë njëjtë, sikurse ne ti je i obligumë, e mbanë familjen me këtë rrogë. Ndërsa, ai osht' shfrytëzues i yti". E kem fillu këtë dialog bukur gjatë. Dhe mas këtëj momenti, se n'qeli nuk lejohej literaturë, u krijunë do raporte shumë interesante me këtë 'kokërrsharrin'. Nga ni ekstremitet që ishte shumë refuzusë, shumë indiferent ndaj nesh, nuk... filloi një afërsi edhe më bijke libra në qeli gjë që s'ishte e lejume. Unë pastaj fillova bojsha hajgare me shokët tjerë. Dhe ata m'ngacmonin mu, "Çka i ke ba kokërrsharrit?"

Po edhe një rast, element ka qenë shumë i randësishëm që the për shejat e komunikimit. Shejë t'komunikimit n'dhomë në izolim e kem pasë "Kosova Republikë" me trokitje. E krijonim tinguj, domethanë sikur Kosova Republikë.

Erëmirë Krasniqi: A kishit mujtë me na e reproduku?

Adem Grabovci: {troket në tavolinë për të demonstru trokitjen} (qeshë) Republikë Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë. Kjo ka qenë sheja identifikuese e jona se jemi kush prej nesh. Jo emrat, po dikush prej t'burgosurve politik që osht'. Gjatë shkurjes... e harrova një element që osht' shumë i randësishëm, unë duke dalë nga zyra e drejtorit, Afrimi ka qenë t'u hy, Afrim Zhitia. Ata ishin tash lart, Afrimi, Sabit Veseli ka qenë, Halil Selimi, Ymer Hasani, Behadini, e disa shokë tjerë, dhe ata tash kishim metë lart, n'dhomat e izolimit. Ne ishim, vetëm ne poshtë, se te ne veç u hasa tyne në rezistencë edhe vazhdu në tutje me i provoku. Dhe tash t'u dalë, veç ma ka bo me gjestikulacion, m'ka pytë Fatmiri... ky Afrimi se a jem n'grevë? Ma ka bo {imiton mimikën e ftyrës} a jeni t'u hangër bukë? Une veç ia kom bo qështu {mohon me kokë}. E tash ai gardiani ish aty, nuk e dije çka u bo (qeshë). Mirëpo, ne u murrëm vesh dhe menihere futen n'grevë edhe shokët lart edhe veç kur i kem ndëgjju se i prunë edhe ata poshtë nëpër qelia.

Dhe kjo ka qenë ajo jeta që me t'vërtetë edhe atje në burg, sado n'kushte të izolimit, sado që kanë qenë përpjekjet për t'na izolu, për ta pengu komunikimin, absolutisht ne kem gjetë forma edhe t'veprimit, po edhe t'bashkëpunimit me të tjerët. Ndërsa, deri n'momentin e daljes nga burgu, ka qenë rregull përpjekjet si zakonisht jonë ba për m'i thy t'burgsunit, për me kërkü falje. Nuk ka qenë praktikë ajo, ka qenë qëndrim kurrësesi. Bile, bile, osht' e çuditshme, mund të jetë në këto rrethana për dikend, po për ne ka qenë shumë normale. Jo falje, se s'kem për çka. Se n'atë moment që ne e kem pasë rregull, ne kërkujmë falje, ne po e pranojmë fajsinë. Ne e kem konsideru veten thjeshtë pengje t'luftës, pamvarësisht prej asaj dhe s'kem kërkü. Dhe e kem ndi veten t'fyem nëse na kanë liru para kohës dhe të gjithë e kem vujtë dënimin deri n'momentin e fundit. Bile, dikun m'i ka borxh Serbia edhe tri ditë, m'kanë majtë ma shumë se sa e kom pasë afatin.

Dhe osht' interesant, zakonisht pjesën e fundit t'burgut, bojnë përpjekje t'kem sjellje ma t'buta, të tregohen ma liberalë për me lanë përshtypjen e mirë, por te ne s'kanë mujtë. Nji mujë para se me dalë nga burgu në '89-tën, une kom qenë i dënumë tridhjetë ditë, kom qenë n'qeli. Pastaj m'ka ra tridhjetë ditë me qëndru në dhomë t'përbashkët dhe pas tridhjetë dite, kem dalë. Dhe n'momentin e daljes nga burgu, ai punëtori i shërbimit të sigurimit sekret që ka qenë, bisedat që i ftojnë edhe m'fton e thotë, fillon tash me bisedu e me lanë përshtypje si nji njeri shumë i edukumë, shumë shpirtmirë, shpirtgjerë e tjera edhe, "Për jetën, çka do t'bëjsh?" Kurrë s'e harroj iu përgjigja... tha, "Çka do t'bëjsh tash? Atë bisedën e fundit zoti Grabovci." Thashë, "As ma shumë, as ma pak. Fjala e..." latinisht e thashë "Fjala e popullit, fjala e së vërtetës. Kurrë nuk do t'largohem prej popullit tim. Gjithënjë do t'qëndroj në mesin e popullit tim" (qeshë). Edhe e kaploi nervoza, s'mujti me përmbajtë vetëveten, dhe u shfry kështu me disa sharje që i kanë pasë të zakonshme. Dhe, ashtu jemi nda me ta.

Pjesa e Katërt

Adem Grabovci: Rrëmujë ka qenë në '89-tën, ngjarje, vllugu. Une menihere mas njizet dite m'kanë kthy n'burg (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: A bon me na jep disa detaje t'lutna? Me çfarë preteksti ju kanë kthy n'burg?

Adem Grabovci: Jom kthy unë meniherë, se kur kom mrri ka qenë protesta e '89-tës, grevat e punëtorëve e tjera, tjera. Kom nejtë veç atë natë që kom ardhë [liru nga burgu]. Ka qenë ambient krejtësisht tjetër se pesë vite, kish ndryshu çdo gja. Tash nipat, ishin rritë mo, për pesë vjet bohen ato ndryshime, s'i njihsha asnjë. Edhe pastaj edhe ambienti normalisht se kish ndryshu. Kem nejtë pak, edhe kem shku pastaj me shokë te punëtorët e autopjesëve të "Ramiz Sadikut" në Pejë. Kur ishin n'grevë e kemi majtë ni fjalim n'Pejë, prej burgu, ni fjalim me punëtorë (qeshë). Qështu ka shku muhabeti.

Erëmirë Krasniqi: Qysh, jeni kthy n'burg prapë?

Adem Grabovci: Prej Peje pastaj kemi shku m'u taku me këta. Disa shokë kanë ardhë me m'vizitu, disa s'kanë pasë mundësi dhe shkova unë se ishin protestat. Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Fadil Vata, Afrim Zhitia e tjerë që ishin. Edhe kom shku, kom ra n'kontakt me ta. Edhe ishin demonstratat në Prishtinë. Kur... i pashë t'gjithë aty kishte t'mjaftueshëm, thashë, "A bon, unë po tërhiqem me interes noshta n'Pejë me shku?" Ata hezitunë për ni moment, se e dijsin se sa kisha dalë dhe përcjellesha, ish normale. Thanë, "Normal, osht' shumë me randësi, po me ni kusht që mos me dalë n'ballë, mos me u ekspozu." Unë isha me t'vërtetë i vendosun që jo mos me dalë n'ballë. Po edhe i bindun se mujmë... edhe pa dalë une, po ndodhi e kundërta. Detyrimisht, u detyrova para Shtëpisë të Mallrave të... njifar, kanë qenë do... edhe tash jonë të betonit n'Pejë, edhe kom hypë n'atë far betonin. Disa fjalë kështu shpejtë e shpejtë edhe menjëherë aty te turma, edhe filloi reagimi i policisë. Aty jom kacafytë pastaj me policë,

tentumë me ia nxerrë revolen ni polici, njifar Maksim Jashoviqi. Edhe ia kom nxerrë revolen atijna, edhe tash e kom shti fishekun se s'kisha mundësi, se u rrëzoja përmi to.

Mirëpo prapa m'kanë kapë, nifar Blerim Gashi m'duket edhe ni goran punëtorë të sigurimit, edhe m'kanë hekë. Normalisht policia, edhe m'arrestunë. Po fati im, m'shtijnë me do t'arrestumë tjerë, disa djem t'ri n'atë far xhipin. Unë e kisha ni jakne t'bardhë, e ni djalë i ri që as sot nuk e di cili osht', e kom deshë, thashë, "A i ndrojmë jaknet?" Edhe e kom marrë, ai e kish pasë t'zezë, une ia dhash atë edhe shkumë atje. Unë veç ndryshova tash dukjen. Edhe mo s'ka mujtë kush me m'shti me pranë se jom kom qenë unë (qeshë). Edhe ai vet që isha kacafytë me te, kur e prunë si dëshmi n'mramje, bukur vonë, pe kqyrë po ia bojnë, "A osht'?" Ai me veti ishte i dyshimtë edhe mo m'leri me kuptu se tash çdo gja varet prej meje, edhe mo s'ka ardhë n'shpërehje. Kështu që, ka shku ajo, edhe jom dënu pastaj ni vit.

Erëmirë Krasniqi: Për çka t'kanë arrestu për ni vit?

Adem Grabovci: Pjesëmarrje e organizim, pjesëmarrje e tjera... qysh e kanë pasë në demonstrata, armiqsorë dihet ato termet që i kanë përdorë. Pastaj në gjykim e kanë bashku veprën me një pjesë të disa t'rijë tjerë edhe...

Erëmirë Krasniqi: A ishit n'Pejë atëhere?

Adem Grabovci: N'Pejë, ky vit ka qenë, vujtja e dënimit ka qenë n'Pejë. Po ka qenë ajo pjesa kur veç ishim n'lëkundje, lirishit n'shpërbërje strukturat. Edhe mosbesimi tash tek përfaqësuesit që i kishim vendorë shqiptarë edhe ata të republikës. Edhe gjatë procedurës hetimore, kryesisht kanë qenë këta të republikës, [jo] të federatës, punëtorët e shërbimit. Pjesa e parë ka qenë me disa vendorë, ka qenë Istref Sadiku, Hamdi Bujupi, Dem Muja, Mehmet Loci, Qazim Mazreku, Xheladin Beqiri, Mustafë Loka që kanë qenë, herën e parë kanë qenë shumë arrogantë, shumë ekstremë, po kanë qenë edhe disa serbë. Po megjithatë, kur m'arrestunë m'pytën, thanë, s'pari po m'pysin ata për pjesëmarrje. "S'pari," thashë, "ju duhet me ditë se sa jom liru nga burgu," thashë, "e dijsa se duhet me ardhë te ju m'u paraqitë." Ka qenë një rregull, se pas pak dite, duhet t'lajmrohëm në stacionin ma t'afërt se jom liru nga burgu.

Po ne kishim qëndrim veç n'burg që nuk do t'i përfillim ato udhëzime, ato ligje. Dhe nuk e kisha ndërmend me u paraqitë te organet e rendit. Megjithatë une e shfrytëzoja atë rast thashë, "Te kush?" "Te ti?" Te pikërisht ai që më merrte n'pytje. Thashë, "Munesh m'i pytë." Po aty shkojke tollovi, nuk u mujke m'u ditë kush kon e ka kërku. Edhe mbet ajo ashtu, po n'mbramje pastaj kur kanë fillu ata n'pytje, kanë ardhë ata të federatës, të Republikës së Serbisë dhe kanë fillu pastaj me pytje edhe me presion thjeshtë që e kanë pasë. Thashë, "Nuk osht' e vërtetë që kom qenë unë" edhe e kanë pru atë policin, e kom vërejtë kur ia kanë hapë derën edhe kur e kanë pytë, ai ishte hezitues. Çdo gja varet tash nga qëndrimi im, edhe une e kom refuzu se nuk osht' e vërtetë, edhe në nifar forme osht' përmbyllë ajo. Po vetë qëndrimi që e kishin marrë ata dosjen edhe fillunë me shfletu dosjen time gjatë vujtjes së dënimit. Pastaj qëndrimet e atij grupi

që ishin në burgun e Pozharevcit edhe qëndrimet e t'gjithë secilit, i kishin, raportet që i kishin edhe mbi bazën e tyre ata pastaj reagojshin.

Edhe ma citunë atë fjalën që ia kisha thonë atij, ia kisha harru emrin tash punëtorit të shërbimit t' sigurimit që ishte në burg dhe i tha se unë do t'jem n'mesin e popullit. Tha, "Ke deklaru..." kështu, kështu. "Po pa dyshim se unë do t'jem n'mesin e popullit dhe nuk pendohem për ate, ashtu do t'baj, do t'veproj." Pastaj kanë fillu me ato masat e tyre që i kanë pasë n'atë kohë të zakonshme, përdorimin e dhunës ekstreme fizike dhe në një moment t'caktumë, vëreja që n'ditën e pestë m'duket të hetimeve që ishin në një mbramje, dhe kom futë dur të nën tavolinë dhe pashë se ata s'kanë të ndalun. Thashë, ma mirë ta bi një vendim, të përfundoj çdo gja. Edhe i kom shti dur të përfuni tavolinës edhe jom çu kom ra mbi ta në tavolinë. Aty u bo rrëmujë, pastaj kanë ardhë të tjerë, m'kanë kapë normalisht, atëherë m'kanë lidhë.

Dhe t'lidhun ashtu, e kanë shfry atë dufin e tyre. T'nesërmen kur e kom pa veten në spital. Dhe ajo që osht' shumë me randësi, që osht' ni kujtim i pashlyshëm te une, një gardian që m'njihte ka qenë Sadik i Strellcit, bukur i moshumë, sjelljet shumë njerëzore, shumë... edhe dhimbja shihej tek ai. Po ka qenë edhe një gardian tjetër pastaj, Jaha, njëri ma kish qitë jaknën, e kish deshë edhe ma kish qitë përmi, se pa vetëdije. E kur m'ka ardhë vetëdija kom nisë me qeshë edhe me... edhe ai shumë i emocionumë se ish shqetësu për gjendjen teme shëndetësore. Edhe po i thomë, thashë, "Çka ke?" Tha, "Po qysh çka kom? A pe sheh çka t'kanë ba?" Thashë, "Shiqo, një ma shumë, një ma pak, s'prishë punë, ne do t'fitojmë." Thashë, "A ke fmi?" Në mënyrë instinktive m'ka ardhë kjo pyetje. Tha, "Po, sonte..." për koicidence i kish lindë vajzë. Tha, "Sonte m'ka lindë një vajzë." I binte një natë ma... thashë, "E ndëgjo mirë edhe nëse vdes une e ti, ajo vajza jote, t'jesh i sigurtë se do ta fitojë lirinë".

Dhe ka qenë shumë interesant pas luftës... realisht pas luftës, se kaloi, po e boj një shkëputje. Pas luftës kur e kom pa atë vajzën, isha me disa miq të degës të Partisë Demokratike në Pejë, Ilami Gashin, Rexhë Abazin, shumë të tjerë dhe u shkëputë ky gardiani, po m'përhëndetë. Tash erdh edhe një vajzë, tash ajo ish rritë, ishte studente. Edhe u nalë, po m'përhëndetë ajo vajza edhe po i thotë vajzës, iu drejtu vajzës tha, n'emër m'vjen keq tash ia kom harru, s'më kujtohet për këtë moment tha, "Babi, ky osht' ai axha që ka thonë që edhe nëse vdes une, ti do ta jetosh lirinë. Shif, ti je rritë tash, je studente, edhe po jeton e lirë".

Këto kanë qenë ato momentet shumë emocionuese edhe jonë thjeshtë të paharrushme. Po kjo periudha tash, kur kanë fillu hetimet, po i rikthehem aty... kishte, e vërejsha atë mosbesimin tashma që nuk e kishin mo shërbimi sekret i... as ai republikan i Serbisë, as i Federatës tek këta xhelatët tonë që ishin sjellë në mënyrë ma t'vrazhdë t'mundshme n'raport me ne. Edhe pse tentonin ta dëshmonin vetëveten me ne, megjithatë ata ishin të anashkalumë. Dhe t'gjitha kompetencat i kishin marrë Federata, i kish marrë edhe Republika e Serbisë. Pra, ishte fillimi i thyrjes së madhe që po ndodhte dhe me gjithë ato përjetimet tona, që normalisht askush s'ka dëshirë të përjetojë gjëra të tilla që edhe m'i kujtu për mu osht'... nuk kam dëshirë me i folë asnjëherë rreth kësaj çështje, po të vërtetat e rikujtojnë një periudhë tepër t'vështirë, tepër t'ronë, jo vetëm individuale, po në përgjithësi si popull se çka kem përjetu. Po n'anën tjetër, osht' ana pozitive, se edhe atëherë ne kem ndi kënaqësi, kur kem vërejtë ato t'çara. Dhe ne kem fitu forcë, kem

fitu guxim që me t'vërtetë kem fillu ta shofim fundin e përfundimin e robërisë së vendit tonë. Dhe kem pa... ato lirisht mund t'i qujë edhe sinjalet e para të lirisë, t' rezultatit të shumë vujtjeve, të shumë dhimbjeve, të shumë sakrificave të popullit tonë që ka bo për liri.

Pastaj ka fillu ajo, pas shkurjes në spital, nuk kem pasë, nuk kem marrë shumë se s'ke pasë edhe për çka se ishin dikun njizet e një ditë që kisha qëndru jashtë burgut. Edhe e kishim t'qartë që nuk kish pasë hapësirë as mundësi për ndonji aktivitet aq t'madh. Për dallim nga pjesa e parë nga '84-ta, që me kënaqësi mund të them që edhe pse kem qenë grup që kem vepru me njëfarë forme në mënyrë shumë t'organizime mrena për mrena, edhe si i pavarun por edhe në bashkëpunim me grupe të tjera, dhe e them me kënaqësi duke iu falemnderu sakrificave, vullnetit, guximit të shokëve të grupit, Xhemal Fetahit, Blerim Muriqit shumë tjerëve, Vehbiut, Demës, Miftarit e shumë tjerëve. Ka qenë një aktivitet i jashtëzakonshëm, shumë i ngjeshur dhe mund t'them se, lirisht se për nga veprimet konkrete që kanë qenë t'asaj kohe, do t'thotë edhe shpërndarja e materialit, shkrumja e parollave, afisheve, e tjera, ka qenë grupi ma frytdhanës, ma i suksesshmi. Ndërsa kjo pjesa tjetër osht' vetëm për një akt. Do t'thotë, mund të më akuzojshin për pjesëmarrje në... që e vërteta ishte që çdo gja kishte shku në mënyrë të koordine me shokët këtu nga Prishtina që kanë qenë në burgun e Pozharevcit. Edhe mund t'them lirisht se merita e rikthimit në jetë të lilegales, veprimit ilegal, të fuqizimit të lëvizjes i atribohet ma s'shumti daljes nga burgu Afrim Zhitisë, Fadil Vatës, pastaj ka qenë Bardhyl Mahmuti e shokë tjerë me t'cilët kemi qenë në burgun e Pozharevcit. Ata që në ditët e para, po ashtu, ata veç janë kyqë edhe janë angazhu në aktivitet.

Erëmirë Krasniqi: A kanë dalë prej burgut me juve?

Adem Grabovci: Jo, ma heret, një vit para meje dikun përafërsisht një vit e pak para meje. Por kryesisht kemi dalë që t'gjithë mrenda dy viteve, kemi dalë t'gjithë. Dhe t'gjithë, pastaj kjo dalje na ka përcjellë t'gjithë se ka qenë edhe fillimi i ndryshimeve edhe në Evropë, edhe në Evropën Juglindore. Shembja e murit të Berlinit që ajo ka qenë kthesa ma e madhe, edhe suksesi ma i madh për shembjen dhe dështimin e sistemit monist. Pastaj janë ndërlidhë edhe këto veprimet normalisht tona. Po megjithatë, le t'krijohen rrethanat sado, kur s'keni mekanizëm për t'i shfrytëzu ato situata n'dobi tonën, ato vijnë e shkojnë. Po fati e ka deshtë se Afrimi, Fadili, Bardhyli, Fahri Fazliu e shumë shokë tjerë kanë qenë edhe i kanë vu n'lëvizje këto situata që kanë gëzu mbështetjen pastaj tek studentët, tek masa e gjerë e popullit dhe e dijmë ato lëvizjet e ato ndryshimet që janë ba.

Po këtu ka përfundu ajo procedura hetimore, na kanë mbajtur edhe pesë mujë, a gjashtë mujë në paraburgim deri sa ka fillu procesi gjyqësor. Dhe n'proces gjyqësor kanë bashku veprën edhe me disa t'rijë e t'reja të Pejës aty që as nuk i njifsha. Ata m'kishin njoftë si emër, dhe përkundrazi kishin pasë një shqetësim për vetëveten meqëse tash na kanë bashku me Ademin, dhe me Ademin na s'kem pasë asnj kontakt. Cili osht' qëllimi i tyre? Edhe me të drejtë, sepse e kanë marrë si masë rënduse.

Po ata kanë pasë atë prapavijë, atë qëllim. Pra ishte shumë me randësi se as ne as s'kishim mundësi të deklarojmë, gjë që ka ndodhur shpesh herë, ku kanë pasë mundësi, në mënyrë t'dhunshme kanë detyru

që t'pranojnë edhe shumë vepra të cilat nuk i kanë krye ata, sepse dhuna është detyruese edhe ato metoda i ka përdorë Shërbimi i atëhershëm, pra lirisht UDB-ja. Po kemi dalë në procesin gjyqësor, n'proces gjyqësor ka qenë po ashtu një skenë shumë interesante. Këta djemtë unë i përqafova edhe pse s'njifeshim. Po u pa qartë se kemi... pikëpamjet tona na bashkojnë.

Erëmirë Krasniqi: A është qai grupi i Myrvete Dreshaj?

Adem Grabovci: Jo, ky është grup tjetër, që kanë qenë t'pavarun, nxënës kryesisht. Sami Elshani, Ismet Elshani, Bekim Kelmendi, dy vajza po m'duken kanë qenë t'Elshanit. Që këta Elshanët njëfarë forme janë edhe si kushëri t'afërm. Që axhen, Adem Elshanin ka qenë në bashkëpunim edhe axha im që ju tregova n'fillim të viteve '50, që është likfidu nga UDB-a. Po ka qenë në kontakt po ashtu edhe me babën. Kanë pasë përveç atyne raporteve, kështu familjare si kushëri nga fisi, kanë pasë edhe raporte të bashkëpunimit. Dhe ato pastaj janë përcjellë te pasardhësit e tyre. Dhe ata tani kanë pasë, ky, ky besim. Por kur shkumë në procesin gjyqësor, gjatë shqyrtimit, fillunë tash me ato akuzat që ishin normale, që i pritsha. Dhe normalisht përvoja e bojke t'veten, tash isha ma i qetë shumë, edhe thjeshtë edhe ma mospërfillës. Duhet t'a them edhe atë që se ishte përcaktimi mos m'i përfillë, si institucione t'armikut. Edhe me konsideru veten si njëfarë forme, që ishim realisht, pengje. Dhe e prunë atë policin, në shqyrtim kryesor. Dhe kom qenë pak ma i plotë, ma i shëndetshëm kur kom dalë nga burgu. Por gjatë asaj periudhës së hetimeve, kisha gjakderdhje t'shumta dhe humba edhe n'peshë, u dobësova bukur shumë. Bekimi edhe Sami Elshani, Bekim Kelmendi dhe Sami Elshani kanë qenë ma t'rijë, po shumë t'zhvillimë. Dhe tash filloi polici, kur pyti gjyqtari, u kuqa. Tha, "A bon me na tregu si duket?" E përshkroi ngjarjen, ka ndodhë kështu, ka ndodhë kështu, taman e spjegoi. Me t'vertetë e nxerra revolen, por fati i keq m'kapën këta dy tjerët e s'mujta me bo aktin e fundit.

Ndoshta fat dhe fatkeqësi se sigurisht që masat atëherë do t'ishin shumë ma t'rrepta. Por, po e përshkruan si skurpulant¹, shumë t'rrezikshëm e tjerë, e tjerë. Tha, "A bon me na tregu cili është?" Tash, unë isha i pari nga rradha, mirëpo unë po shiqoj nga Bekimi. Edhe ai tash qysh e përshkroi, realisht duhet t'jetë Bekimi ose Samiu. Edhe po thotë, "Ky..." ai tha, "T'lutem, a bon edhe njëherë, saktësisht cili është?" Edhe ai iu drejtu te Samiu. Po, si i i disiplinumë, si shërbëtor, kështu i devotshëm që ka qenë Ukë Muçaj i sistemit t'kalumë. Ju drejtu, tha, "T'lutna, edhe njëherë cili është?" Edhe ia ka bo me gisht n'drejtim timin. Aty, pastaj ka reagu masa që ishin familjarët duke e përcjellë shqyrtimin. Edhe, e kom ndëgjju zërin e vllaut t'madh, tash dëshmor, t'cilin e kom pasë n'mbështetje n'vazhdimësi dhe ka reagu. Tani ka marrë vendim aty për aty gjyqtari edhe i ka përjashtu t'gjithë nga pjesëmarrja në shqyrtim.

Dhe pastaj ka vazhdu procedura, fillova unë me disa akuza, fjalë, që ishin normal n'raport unë, ne si t'akuzumë, me ta. Edhe përfundoi, atëhere jemi dënu. Unë jom denu një vit, ata djemtë e ri m'duket ma pak, disa jonë liru krejt. Por e mira ishte se u lirimë t'gjithë, mbrojtje n'liri edhe unë me ta. Dhe pastaj fati prapë m'ka përcjellë, ka qenë vjeshta e atij viti. Dhe një rast ka qenë gjatë hetimeve, por para se me u burgosë. Unë isha i fejumë, pasi kishim shpallë fejesën me bashkëshorten, realisht ajo e kish shpallë, pasi isha arrestu unë. Dytë ishim studenta, ishim njoftë dhe kur dulëm ne planifikojshim tash t'martohemi. Dhe

¹ I intervistuari përshkruan madhësinë fizike.

ishim në Gjakovë, kishim një javë prapa, ashtu diçka kishim planifku t'martohemi. T'u kthy prej Gjakovës, n'autobus, një kangë "Moj Erlinë" m'duket..."Moj Erlinë, merr xherxhefin eja të rrijmë" edhe n'mënyrë instinktive. Por kur kemi shku n'burg, gjatë procedurës tatimore për me mbyte atë zhurmën, ato që boheshin në zyrët e UDB-së e lëshunë pikërisht atë muzikë dhe ma rikujtoi dhe m'ka mbetë n'kujtesë pastaj gjithnji m'ka përcjellë kjo kangë dhe kom pasë si kangë t'dëshirushme.

Po edhe pas lirit nga burgu, prapë, do t'thotë, vjeshta e '89-tës ka qenë, m'ka përcjellë i njeiti fat, prapë ka qenë vlimi i trazirave. Edhe pastaj kom marrë iniciativën n'ato rrethana, jem taku me t'gjitha grupet, se tashmë ishin liru Havë [Shala], e Myrvete Dreshaj, pastaj grupi "Pavarësia" që ka qenë Ibrahim Dreshaj e shumë të tjerë, Nezer Nikçi me një grup tjetër. Që këto dy grupet kur jonë arrestu, që kishin njohje me ta, ata kur kom qenë une student e jom arrestu ata kanë qenë nxënës, por ishin pjesë që kishin kontakte me Xhemail Fetahin, me Fahri Bërdynën, me Blerim Muriçin, e tjerë. Dhe ishte lidhja jonë që ishin grupe tjera. Se qëllimi ynë ka qenë që të shtrijmë aktivitetin tonë sa më shumë horizontalisht, dhe t'përfshihen sa më shumë, por jo m'u... organizimin e grupeve t'vogla, që t'shkëputet pastaj, mos t'bijmë gjithë. Dhe për fat tonin t'mirë, asnjë, nuk kanë ra t'gjithë menjëherë. Ata kanë vazhdu pastaj aktivitetin kur jom dënu unë herën e parë. Por pas një kohe ata jonë arrestu, por kur jonë arrestu, atëherë kanë tentu edhe ne t'na përfshijnë në hetime. Në Pozharevc, ka qenë, m'kanë marrë n'pytje disa herë, por jo, nuk osht' hapë ndonjë procedurë ndaj nesh. Por fati i mirë që kur dulëm ne nga burgu, jonë dalë t'gjithë ata. Dhe hapin e parë që e kemi marrë dhe që e kemi pa të domosdoshëm, riorganizimin e t'gjitha grupeve. Dhe aty jemi riorganizu. Pastaj kemi fillu aktivitetin shumë t'ngjeshur.

Erëmirë Krasniqi: A osht' kjo organizata ilegale?

Adem Grabovci: Gjithnji po flas për në ilegalitet. Udhëheqëse ka qenë Lëvizja Popullore e Kosovës. Qoftë kontakte të drejtpërdrejta apo të tërthorta. Dhe kemi pru pastaj, si grup, që pastaj kemi pasë kontaktet herën e dytë, se tash ishte liru edhe Ramdan Avdiu dhe shumë shokë tjerë. Edhe kemi fillu aktivitetin në regjionin e Dukagjinit, jemi fokusu ma tepër. Ku kanë fillu pastaj protestat, kanë qenë shumë të përgjakshme, sepse tashmë ishin ato shkëputjet e fundit të Federatës Jugosllave. Kishin fillu të ndihen pakënaqësitë edhe në Slloveni, edhe t'manifestohen shumë hapur. Në Kroaci poashtu. Dhe normalisht, ngjarjet në Kosovë. Dhe vetëvetiu, atëherë e bojshim të domosdoshme që të jemi shumë ma aktiv.

Erëmirë Krasniqi: E çka ka qenë si kërkesë në këto protesta?

Adem Grabovci: Po si gjithnji, kërkesa ishte që Kosova Republikë, pra që edhe ne të jemi të barabartë me republikat e tjera. Ende nuk kishim kalu n'atë fazën e fundit, shkëputjen apo diçka. Por n'kuadër tyre, tash ato vrasjet që, vrasje e... Dacit, Fatmir m'duket, Fatmir Ukës, Gani Dacit e disa të tjerëve që ka ndodhë, ato, na n'mbramje zakonisht tërhiqeshim nga protestat, t'shumbtën e rasteve ke pasë si bazë, mund të them, shtëpinë time që ishte në periferi të qytetit të Pejës apo kemi shku te daja i Nezir Nikçit, shpesh herë në shtëpinë e dajës tij. E kemi shfrytëzu pastaj shtëpinë e djalit t'axhës së Xhaferit, që po ashtu e kom pasë n'vazhdimësi n'mbështetje të pakursyer. Dhe bonim plan për ditën e nesërme, por

shpesh kemi kalu, herë në komunën e Istogut në organizim të protestave dhe jemi nda në grupe. N'komunën e Deçanit kemi vepru shumë, Pejës, Istogut dhe kemi fillu pastaj në organizim të protestave. Dhe ishte, do t'thotë, ka qenë nëntori, fundi i nëntorit, dhjetorit, aty dikun, para fillimit të vitit t'ri. Nji natë kemi shku n'shtëpinë time dhe kemi debatu gjerë e gjatë, tashmë veç ishin bo disa ditë që kishim demonstrata, normalisht që edhe masa filloj të lodhej.

Pjesa e Pestë

Edhe nëpër burgje, ne kemi diskutu shpesh here për vëllavrasjen që ka ndodhë. Ka qenë ni preokupim me çdo t'keqe, çdo dukuri negative ka qenë shqetësim për t'burgosunit. Sepse ne kem pasë dëshirë që vendin tonë, popullin tonë t'a shofim sa ma mirë. Por kur kem shku atë natë në shtëpinë time me Hava Shalën, Ibrahim Dreshën, Myrvete Dreshaj, Lulëzim Etemi, ka qenë mesa ime Lulja, vëllau Dini që na ka pritë. Si çdo natë kish organizu edhe ngrohjen e gjitha ato, ushqimet. Dhe pasi kem përfundu edhe gjatë darkës, ne kem debatu se si do t'veprojmë. Dhe e kem pa të domosdoshme se duhet t'gjindet nji formë që ne të depërtojmë n'masë, por njikohësisht t'mos ketë mundësi UDB-ja me n'a ndjekë. Dhe ishte një iniciativë, ma e drejta ishte fillimi i pajtimit të gjaqeve.

Për këte, gjatë bisedës Hava na tregon ni rast, thotë, "Sot e pashë ni t'ri," se ka qenë ajo thirrja, "Kush s'bashkohet është tradhëtar," dhe e ka vërejtë ni t'ri që fatkeqësisht s'ia di tash emrin, edhe duke qajhtë. I thotë, "Eja afrohu!" I thotë, "Une do t'isha afu me ju, do t'kisha marshu me ju, dhe me ju jam. Po une jam në gjak, jam në hasmëri ne fqinjim tim. Dhe po t'u bashkangjitem kam frikë që hasmi do t'më godet. Do t'më vret mu, dhe pastaj do t'a komprometoj Lëvizjen, do të thotë protestën," se "Shqiptarët po vriten mes vete." Dhe ajo ka qenë shumë prekëse për t'gjithë ne.

Edhe pastaj kemi vendosë, përveç që i parashtrumë si detyrë, si qëllim vetvetes anën humane, që padyshim ishte nji plagë shumë e randë për popullin tonë, ne vendosëm që ta shfrytëzojmë këte. Nuk ishte qëllimi kryesor, duhet t'jem shumë korrekt, shumë i sinqertë. Që natën e parë ne kemi bisedu se ky nuk do t'jetë qëllimi i jonë kryesor. Qëllim po, vepër e mirë humane po. Po asht' ni moment që ne e shifshim shumë t'mira, shumë dobi prej saj: nji, do t'a luftojmë nji dukuri negative që ishte mbjellë dhe ishte ushqy nga pushtuesi, nga pushteti i atëhershëm, për qëllim të ndarjes, përçarjes së popullit tonë. Dhe e dyta, ishte nji mundësi që ne të depërtojmë n'masë, t'i bëjmë thirrje masës për tu përgatitë thjesht për luftën e armatosur.

Dhe ne kemi pasur si moto n'fillim, kanë qenë dikun n'nivel t'Kosovës nëse s'gabohem 37 viktima, të vvarë, tre në protesta. Dhe kemi shku me moton, "Ne do t'a kërkojmë shtrirjen e dorës së pajtimit, faljen e gjakut në emën të Kosovës, dhe për t'i ngjallë të vdekunit." Se kemi vlerësu se me ni pajtim t'mundshëm, ni falje të gjakut, ne do ta ngjallim një të rënë nga protestuesit. Dhe ne si pikësynim kemi pasë fillimisht me arritë 37 gjaqe m'i pajtu. Dhe pastaj kemi elaboru ngadalë, pa ndonji ceremoni t'madhe, po shumë thjesht. Qe atë natë kanë qenë mysafirë edhe Flamur Gashi, Serbeze Vokshi, Bajram Kurti tek unë, që na janë bashkangjitë në debat. Dhe e kemi elaboru këtë çështje gjerë e gjatë. Dhe kemi fillu pastaj anët

positive, negative, dhe kem fillu si duhet tash ne të veprojmë. Dhe i kem nda të gjithë rolet, se kush cilin rol do ta ketë.

Biseda jonë e pare tash ka qenë edhe ndarja e detyrave n'kuadër të grupit. Identifikimi, ni grup ka qenë m'i identifikimi njerëzit të cilët mund t'jenë me ndikim, autoritete. Ma tepër autoritete morale t'them të drejtën. Njohës të muhabetit t'odave, se si duhet t'shkojnë. Dhe pastaj kemi ardhë në përfundim, i kemi identifikimi disa në regjionin e Pejës, dhe kem parapa si të domosdoshëm edhe lidhjen e shtresës së intelektualëve t'lartë, profesorëve të Universitetit, njerëzve edhe të shkencës, me masën. Që kishim, lirisht mund t'them se deri n'atë kohë ka qenë ni shkëputje shumë e madhe.

Në takimin e parë ne kem parapa edhe me Rexhep Qosjën, që e kem pasë ni autoritet kështu, edhe ushqim lirisht mund t'them, edhe disa tjerë. Edhe gjatë vuajtjes së dënimit shpirtënor, pastaj që na ka bo për veti me qëndrimet e veta që i ka majtë gjatë t'gjitha periudhave kohore, dhe disa të tjerë. Pastaj kanë qenë, sygjërimi ynë n'atë kohë edhe për kontaktin me Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave t'Njeriut që ka funksionu n'atë kohë, n'krye të së cilit ka qenë Zekeria Cana. Dhe edhe njani, edhe tjetri, na kanë sygjëru që t'a ftojme dhe t'bisedojme për këtë çështje, si njohës të folklorit dhe studiues, profesorin e nderuar Anton Çetta.

Kem shku edhe te profesor Anton Çetta, kem bisedu, kem elaboru qëllimin tonë. Edhe njërit, edhe tjetrit, i kem spjegu qëllimin tonë final se cili është, se qëllimi ynë nuk është vetëm luftimi i kësaj dukurie, qëllimi jonë final është: ne duhet të përgatitemi për luftë të armatosur. Dhe ta shfrytëzojmë luftimin e kësaj dukurie që nëse vepron kundër nesh institucionet e shtetit t'atëhershëm të Serbisë, atëherë ajo ishte një vepër humane dhe ishte një kompromitim shumë ma i madh për Serbinë.

Po fillimisht faleminerës pi tyne, nuk e kanë kuptu qëllimin, dhe na kanë leju ni hapësirë t'libër t'veprimt, për ni periudhë t'caktume. Po pas bisedave që i kemi pasë me profesor Antonin, që e ka pranë kërkesën tonë, e ka arsyetu shumë shumë mirë dhe na ka dhanë mbështetjen. Na ka inkuraju që ne të startojmë, t'i identifikojmë rastet. Dhe pastaj kemi bisedu edhe, na ka sygjëru me profesorin atëhere Ibrahim Rugovën. Edhe ai na ka dhanë mbështetje. Kem pasë pastaj edhe disa profesorë të tjerë që kemi bisedu me ta, po fillimisht kanë qenë këta. Mujë Rugovën, profesor Mujë Rugovën, e disa të tjerë që kanë qenë ish të përndjekur, të burgosur, e të ekspozumë ndaj UDB-së, ata i kemi konsultu në vazhdimësi, dhe kanë qenë pjesë e jona. Dhe kanë merita të jashtëzakonshme për fazën fillestare të fillimit t'pajtitimit t'gjaqeve.

Dhe jemi kthi pastaj prapë. Kemi ba takimet në Pejë, ku kemi kriju grupet punuese për identifikimin e rasteve: ku janë, kush me kend është në hasmësi. Dhe jem dakordu edhe me profesor Antonin. E ka mbështetë idenë tonë që ne duhet t'i identifikojmë vetë njerëzit, dhe të shkojmë pa e ditë pala dëmtuese, po kemi shku vetëm tek pala e dëmtume, pra vetëm te familja që ka pasë me shtri dorën e pajtitimit, me falë gjakun. Ne po ashtu jem tregu të kujdesshëm që edhe simbolika edhe fillimi, vendi, ku ta gjejmë adekuat, që t'fillojmë me t'mbarë. Dhe kemi shku në fshatin Lumbardh, që e kemi lidhë edhe n'aspektin figurativ lumi-bardh, që e ka kuptimin e vet. Po njikohësisht edhe familja Ukaj kanë qenë të fshatit Lumbardh. Dhe aty kemi fillu rastin e parë të pajtitimit të gjaqeve.

Ka qenë ni rast tepër i randë. Pastaj rastin e parë ku është shtri dora e pajtimit asht' në komunën e Pejës, në fshatin Raushiq, te ni familje shumë e madhe, me shumë ndikim, që ka ndodhë ni vrasje e shumëfishtë, familja Buçolli. Që kanë shku edhe hoxhallarë edhe pleqnarë, edhe ku di une, t'shumbtë, dhe janë tregu të pasuksesshëm. Shkuarja jonë... se ajo familje është familje e njohur për nga ndikimi në trevën e Dukagjinit edhe [për] nga atdhedashuria gjithsesi. Ne kem ba përpjekje edhe këtë element t'a identifikojmë, orientimin e tyre, sa do t'kem besim dhe deri n'çfarë shkalle do t'mund t'shpohemi lirisht n'këtë familje.

Dhe kur kem shku për herë t'parë, kem kërku shtrirjen e dorës së pajtimit. Na kanë pritë shumë... n'mënyrën ma t'mirë t'mundshme. Kem fillu pastaj debatin. Gjatë javës ne kem pasë për detyrë identifikimin, dhe kem shku ne si grup i t'rive, që e kem qytë parapërgatitje e rasteve për shtrirjen e dorës së pajtimit. Pastaj ka ardhë profesor Antoni me të tjerët: Zekeria Cana, Mujë Rugova, Muhamet Pirraku, Ramiz Kelmendi, Mark Krasniqi. Na u ka bashkangjitë avokati i ndjerë Bajram Kelmendi, e shumë e shumë të tjerë që kanë dhanë kontribut. Po fazën e parë kur e kem fillu, ende pa u ba publike, dhe kur kem fillu, nuk kem pasë ndonji ngacmim nga institucionet e shtetit, nga policia, por kur kem fillu na me dalë në skenë, në sipërfaqe, aty pastaj e kanë vërejtë rrezikun që po i kërcënohet. Dhe kanë bo përpjekje pastaj për t'na pengu edhe me na arrestu.

Gjatë kësaj kohe, pikërisht t'u ba përpjekje m'i identifiku miqtë, dashamirët e familjes Ukaj, por edhe të familjes në Raushiq, ne na u vu prapa. Kem qenë me Havën, me Ibrahimin, Lulëzimin, Myrveten, do të thotë bërthama e këtij Këshilli t'Pajtimit, pra nismëtarët që ishim, te vorret m'duket Kakariqit i thojnë në komunën e Pejës, në një rrugë që ishte me dalje po mure n'dy anët, dhe kanë tentu me na arrestu. N'dy anët na ka dalë policia, po ne kem kcy për fat në murin e vorrezave edhe iu kem shmangë këtij rasti.

Dhe aty pastaj ne kem vazhdu ma tutje. Shtrirja e dorës t'parë t'pajtimit që është ba te familja Buçolli, aty ka qenë me t'vërtetë ni moment shumë prekës, edhe nga ana e familjes. Se ne e kem kuptu se ka ngjallë emocion, dhe paraftyrime t'gjitha skenave të padëshirueshme për atë familje. Po ka qenë edhe për ne ni emocion i veçantë. Dhe aty kem pa atë rezultatin e veprës sonë edhe humanitetin, edhe shumë anë tjera të suksesshme. Elementi i dytë që na ka ndihmu shumë në rrugëtimin tonë, ne kem pasë rregull që ditën e parë, familja që e falë gjakun, ajo do t'jetë pastaj bashkëudhëtar i yni. Do të vie drejtpërsëdrejti me ne t'na shoqëroj si shembull për familjet e tjera. Dhe vërtetë kjo ka dhanë rezultat shumë t'madh. Përfaqësuesit e familjes Buçolli, kur kanë ardhë në familjet e tjera, e i kanë spjegu emocionet e tyre, përjetimet e tyre, se n'çfarë gjendje t'presionit kanë qenë para faljes së gjakut. Që thjesht edhe familja e t'vrrarit edhe familja e dorasit kanë qenë në presion, kanë bo ni jetë të pasigurt. Njëri nga frika e hakmarrjes dhe tjetri se nuk është lehtë për askend që t'shtrijë dorën dhe ta ngrehë gishtin kundër vëllaut t'vetë.

Por, analizat që i kem ba, se çdo natë kur kem përfundu punën në terren, ne i kem ba analizë pothuajse çdo rasti veç e veç. Dhe që në t'gjitha rastet, n'pjesën dërrmuese, na ka dalë pushteti mbrapa si nxitës. N'rastin konkret, ka qenë kontest pronësor, që me një vendim të drejtë të institucioneve përkatëse t'kohës, ai problem do t'ishte zgjidhë, dhe nuk do t'kishte pasë vrasje. Por vendimet, një proces ia ka dhanë njanës palë, herën tjetër ia ka dhanë tjetrës palë, dhe ka nxitë konfliktin deri sa ka ardhë vrasja. Dhe qëllimi final: përçarja e familjeve me ndikim, do të thotë me ulë ndikimin e atyne familjeve, dhe autoritetin e tyre me

dëmtu para masës, që ne mos me pasë thjesht autoritet. Dhe këto pastaj i kem transmetu edhe tek familjet e tjera, dhe kem vazhdu me pajtimin e gjaqeve.

Në një afat rekord disa ditë, kem arritë, herën e parë kur e kem ba bilancin kanë qenë 16 raste që i kem falë, do t'thotë i kalojë t'gjitha parashikimet, dhe kjo ishte vetëm në zonën e Dukagjinit, që pastaj fillunë edhe publikimet në media, që na kanë ndihmu shumë n'atë kohë.

Erëmirë Krasniqi: Cilat gazeta kanë qenë n'atë kohë?

Adem Grabovci: Po ka qenë "Rilindja", kanë qenë "RTP-ja". Po kanë fillu edhe mediat e huaja t'marrin pjesë. Nëpërmes Këshillit për Mbrojtjen e t'Drejtave të Njeriut, kanë ardhë pastaj edhe shumë delegacione që na i janë bashkangjitë, që i ka bo përshtypje ajo. Dhe pastaj na janë bashkangjitë edhe kleri. Ni kontribut jashtëzakonisht t'madh, që na kanë dhanë ni ndihmesë t'pa kursyer, hoxhallartë edhe priftërinjtë. Që edhe kisha edhe xhamia, për ne kanë qenë, i kanë hapë dyert për ne, dhe i kem pasë si shtëpi tona. Edhe hoxhën edhe priftin, ne i kemi marrë bashkarisht në pajtimin e gjaqeve. Dhe ajo ishte një mesazh para botës tjetër, se kjo është një e keqe e përbashkët. Ishte një mesazh i bashkëjetesës, i drejtpërdrejt, i bashkëjetesës së feve, se ne respektohem mes vete, edhe katolikët, edhe myslimanët. Dhe kur t'janë intereset e përbashkëta, na jemi një. Dhe kjo ka qenë ni shembull dhe një sukses i paparashikimë nga ana e jonë, që do t'a çojmë këtë mesazh tek bota demokratike. Kemi pastaj përfaqësues t'asaj kohe, senatorë të Belgjikës Vili Kupers, e shumë t'tjerë që kanë ardhë kanë marrë pjesë n'atë aksion.

Erëmirë Krasniqi: A keni pasë një ceremoni ma t'madhe, që njihet për qatë kohë?

Adem Grabovci: Po fillimisht faza e parë ka qenë në oda, falje në mënyrë individuale. Me kalimin e kohës, ne kem arritë gjatë javës t'na shtrihet dora e pajtimit, pa prezencën e profesor Antonit dikur. Dhe gjatë javës ne kem arritë shtatë-dhjetë, apo dymbëdhjetë raste m'i përgatitë, me na u falë dhe me shku t'sigurtë. Se ne nuk kemi deshtë me maltretu profesor Antonin, po kur kemi pasë ndonjë rast shumë të vështirë, profesor Antoni asnjherë s'ka heziku me ardhë s'bashku me ne. Edhe n'kohët ma t'vona t'natës, ne e kem pasë bashkë me ne prezencën e profesor Antonit dhe të profesorëve tjerë pastaj që na kanë mbështetë. Dhe u bamë një: edhe intelektualët edhe t'gjitha shtresat, edhe studentët u bamë një me popullin. Dhe pastaj ne e kem pa të domosdoshme dhe me interes t'kalojmë në pajtimet grupore, që është ba pastaj edhe një ceremoni e rastit ku kanë marrë pjesë pastaj me qindra, me mijëra qytetarë, ku janë falë me dhjetëra gjaqe, ngatërresa, plagët, e tjera.

Dhe një e veçantë që ka qenë n'ditët e para dikund, n'dhjetë ditëshin, apo n'15 ditëshin e parë, ku kishim arritë për një kohë veç me kalu tash 30-shin, një plak që ish marrë prej kohësh me pleqëni në Lugun e Baranit, në një odë, na pyetë, thotë, "A ban, ni pyetje e kam?" Se na pyeti për rezultatin, edhe i tregumë, tha, "Une po iu them juve, çka po e ban t'suksesshëm aksionin e jujë?" Dhe ne fillumë me ato anët humane, jo kjo, jo situata. Tha, "Jo, une po iu tregoj, ne kemi pasë rast me shku në një familje me nejtë 41 ditë, qysh ka qenë n'rregull. Në 42-tën ditë ka qenë rregull me u falë gjaku. Kemi hanger, kemi pi n'atë familje, pa dalë hiç, pa i ndërpre muhabetet. Kur kem shku në 42-tën ditë, ishte faza finale për me na u falë, m'u shtri dora e pajtimit, m'u falë gjaku. M'është deshtë me ba be se nuk kemi asnjë interes," por, siç u shpreh ai, "kemi

ardhë hilaf-hilaf për riza t'zotit, po se vetëm ana humane. Po n'atë moment kur kem deshtë, kur kom bo be dy herë, herën e tretë m'u ka kujtu se vrasësi na kish dhanë dy lira, apo tri lira, na i kish futë n'xhep. Mu m'është nalë dora dhe m'është mbyllë goja. S'kom mujtë me bo be dhe s'na është falë gjaku." Tha, "Unë po iu them juve me babën, vazhdoni se keni me qenë t'suksesshëm sa t'jeni me xhepat bosh. Me xhepat bosh ju keni me ecë përpara. A ne kemi qenë me xhepa plot, prandaj nuk kemi mujtë me dhanë sukses, sepse ne e kem ba për interes personal, për përfitime. Ju po e bëni për interesin nacional, për interesin e shtetit, çlirimit të vendit".

Dhe kështu kem vazhdu. Kemi raste nga më të ndryshmet. Kemi raste kur është falë edhe dy gjaqe, tri gjaqe edhe ma shumë. Asht' rast shumë i ndishëm rasti i familjes Demaj, t'komunës t'Klinës, të profesor Marian Demës, ku ka shtri dorën e pajtimit dhe ka falë gjaqet e vëllezërve që i ishin vra. Pastaj kem pasë raste tjera kur... edhe ni rast që mendoj, peshonalisht që m'ka mbetë në kujtesë, po ashtu në një fshat t'Lugut t'Baranit, te familja Shalaj. Posa kem trokitë dhe kem shku, tashma çdo kund i kishin dyert e hapura. Në një formë a n'formën tjetër, na pritshin se do t'shkojmë një ditë.

Dhe dulë nana e të vrrarit që e kish humbë djalin n'moshë shumë t're, 17-18 vjeçar, dhe na u drejtu me fjalët, "Ejani pllumat e nanës, se nana iu ka pritë që sa ditë." Edhe na kanë shti n'odë, kemi fillu bisedat. N'bisedë e sipër u ngrit dhe na ka sjellë, "Para se t'ia shtrijë dorën e pajtimit, une po ua jap maicën, do t'thotë fanellën, që kishte pasë në trup djali në momentin kur është vra, me shqiponjën." Dhe ishte me vrima. Ishte moment tepër i vështirë. Dhe së dyti, i ka thirrë t'gjithë fëmijtë tjerë, djemtë, dhe tha, "Për Kosovën do t'ia fali edhe djemtë e gjallë që janë." Dhe s'fundmi, na ka shtri dorën e pajtimit. Dhe ky ka qenë vërtetë moment tepër prekës për t'gjithë ne, dhe do t'jetë i paharrueshëm. Që vërtetë djemtë e asaj nane pastaj për fat të mirë i kem pasë edhe bashkëluftëtarë në luftë. Dhe janë djemë shumë meritore për filllet e para të organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pastaj kem pasë raste kur na i janë dhanë fishektë e pushkës që familja i ka rujtë për dorasin. Dhe na i kanë dorëzuar karikatorët e fishekëve që i kanë rujtë, "S'pari po ia falim këta." Pastaj na e kanë shtri dorën e pajtimit. Dhe kjo atmosferë pastaj ka reflektu gjithandej Kosovës. Masovizimi ka qenë ma... i ka përfshi t'gjitha trojet shqiptare. Ma tepër ato të robëruara, pra edhe ato në Mal t'Zi, në Maqedoni, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, ku edhe atje i kem pasë Këshillet e Pajtimeve, dhe kemi fillu organizimin dhe veprimin tonë edhe atje.

Bile m'kujtohet, se pas një kohe neve fillunë policia të na ndjekin dhe n'bisedë e sipër, tash kryesisht bërthama e jonë ishte... tash ma... kishim ra n'sy dhe ishim të ndjekun. Edhe Hava kërkohet, edhe Myrvetja, edhe unë, Ibrahim, Lulëzimi, dhe disa shokë të tjerë. Po kryesisht në t'gjitha trevat e Kosovës kanë qenë të organizuar. Fillimisht bërthamat i kanë organizu ish të burgosurit politikë. Dhe ata e kanë marrë punën me shumë përkushtim dhe shumë disiplinë. Dhe pothuaj n'çdo fshat, n'çdo lagje, kemi pasë nga një bërthamë të organizuar dhe kemi vepru si trupë e koordinime në nivel t'vëndit.

Pastaj kur jem rreziku në Kosovë, një bisedë gjatë analizave të zakonshme që i kemi ba, po n'prezencën tonë edhe Anton Çetta dhe shumë veprimtarë të asaj kohe, u ngritë si çështje rrezikimi i jonë dhe mundësia e arrestimit. Dhe ne pa hezitim thamë, "Po edhe nëse arrestohemi, do t'jetë ni e dobishme."

Profesor Antoni tha, “Po si do t’jetë e dobishme? Iu marrin n’ortura, t’gjitha.” Thamë, “Po ne i kem përjetu, profesor Anton, ato tortura.” Dhe ndërhyri Zekeriai, “Anton, une e kom marrë ni çertifikatë,” që e kish marrë ni dosje timen, ku e kish gjetë Zekeria Cana, dhe thotë damet që m’kishin shkakto gjakderdhje, që kisha pasë për vesh, hunde, gjithandej, thotë kështu, kështu, “n’këtë gjendje e...” “Profesor,” thashë, “e vlenë, sepse aksioni i jonë do t’jetë shumë ma i suksesshëm, se do t’ndikojë pozitivisht në revoltë. Do ta nxisë atë revoltën e qytetarëve të Kosovës, së shqiptarëve. Dhe do t’a shofin se vërtetë, do t’dëshmohet se UDB-ja është e interesime që na t’jemi n’hasmëri me njëri-tjetrin.” Edhe u stepën dytë, tha, “Edhe kjo do t’mund t’ndodhë? Do t’thotë edhe këtë sakrificë jeni n’gjendje ta bëni?” Edhe pse ne, t’them t’drejtën, nuk e bëmë me ndonji qëllim, por thjesht ishim t’bindur se nëse arrestohet ndonjani prej nesh, ajo do t’ndikonte pozitivisht në masovizimin e Lëvizjes sonë. Dhe ne ishim t’gatshëm për çdo sakrificë.

Po ne kalumë pastaj, murrën një vendim që grupin në Pejë t’a përfaqësonte Rexhep Kelmendi, Xhemajl Fetahi, dhe shumë tjerë që ishin, dhe ne kem kalu pastaj në zonat tjera, kem vepru. Dikush kah Rahoveci, Prizreni, Suhareka. Dikush kah zona e Drenicës dhe kem masovizu.

Erëmirë Krasniqi: Qysh i identifikojshnit njerëzit?

Adem Grabovci: Njëpërmas Këshillave t’Pajtitimit që u formunë, gjithsecili n’lagjen e vetë. Pothujë, gjithandej ka pasë t’burgosun politikë që jemi njoftë me njëri-tjetrin dhe kemi pasë besim te njëri-tjetri. Pastaj ka qenë Lëvizja Studentore që ishim një me ta. Dhe ata na dhanë mbështetjen e pakursyer. Dhe ata pastaj, gjithsecili ka marrë detyrë dhe ka shku tu e angazhu njëri-tjetrin dhe janë angazhu që t’gjithë.

Dhe kem vazhdu kështu aktivitetin tonë deri te falja ma e madhe që asht’ bo, kem pasë tubime pothujë në t’gjitha trevat. Asht’ tubimi ma i madhi, ka qenë ndër ma t’mëdhatë në Bubavec. Hoxha që ka qenë përkras shumë i madh i joni, Kokraku, pastaj shumë hoxhallarë tjerë. Në Novosellë t’Gjakovës gjithsesi. Në kishën e komunës së Klinës në Zllakuqan. Po ashtu ka merita shumë t’mëdha edhe n’tubimin masiv që është mbajtë. Por edhe gjithandej trevave tjera, në Prishtinë, t’gjitha trevat.

Kulmin e ka arritë në tubimin te Verrat e Llukës, që është një vend historik, i zgjedhur jo rastësisht, po thjesht si ni vend ku para fillimit të luftës, edhe Haxhi Zeka e kështu me rradhë, n’kohën e Besëlidhjes, aty është ba besa-besë dhe janë falë gjaqet para fillimit të luftës. Dhe ne kem deshtë t’a çojmë ni mesazh. Pikërisht simbolika ka folë vetë. Dhe te Verrat e Llukës llogaritet që dikun kanë qenë mbi tetë qind mijë njerëz të tubuar nga t’gjitha trevat e Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: A mundesh n’detaje ceremoninë, me na tregu qysh?

Adem Grabovci: Po ne fillimisht kem shku te Verrat, kem pasë Këshillin e Pajtitimit në komunën e Deçanit, të organizuar, t’udhëhequr nga veprimtari i njohur, ish i burgosur politik, njeri shumë meritator, Jashar Salih. Dhe s’bashku me Jasharin dhe aktivistat në Komunën e Deçanit, kemi identifiku vendin se ku. Dhe kem shiqu atje edhe ni lëndinë ku ka qenë me mbeturina dhe zhavorr t’shumtë. Dhe kem fillu pastaj aksionin për me pastru dhe me përgatitë terrenin. Po ashtu, i kem nda edhe rolet. Ni kontribut shumë t’madh që e ka dhanë është edhe fotografi Sali Cacak, në Pejë, që na ka përcjellë çdo kund, pothujë që nga ditët e para. Dhe ka ndiku pastaj edhe me fotografitë e tina që i ka plasur edhe tek mediat, që ka ndiku

shumë pozitivisht në masovizimin e kësaj Lëvizje. Edhe te Verrat e Llukës ka qenë shumë aktiv, s’bashku me Jasharin dhe të tjerët, që vërtetë ai tubim t’del sa ma madhështor.

Kem pasë frikën, normalisht, t’grumbullimit të njerëzve. Është normale, e sinqertë, se ne nuk e kem parapa se do t’jetë aq masiv. Që do t’ketë pjesëmarrje ne ishim të sigurtë, se ishin të përgatitura dikun ni numër shumë i madh, me dhjetëra gjaqe për tu pajtu, ngatërresa. Por nuk e kem parashiku që do t’jenë aq masë e madhe. Ajo që është po ashtu me rëndësi të ceket, gjatë përgatitjes së terrenit, ne kohë pas kohe, si bërthamë, që na qujshin atëherë Këshill Inicues, na kanë ftu në çdo mes. Shumë raste kanë kushtëzuar me pjesëmarrjen tonë në pajtim, “Kërkojmë që t’vijë...” nganjherë edhe me emra, por zakonisht, “kërkojmë Këshillin Nisëmtar të vie.” Dhe nuk kem hezitu, kem shku pa pritesë.

Pjesa e Gjashtë

Kemi marrë pjesë n’mënyrë t’vazhdueshme, kem mobilizu, vullnetarisht na janë përgjegjë njerëz me eskavatora dhe mjete tjera, po edhe fizikisht, për rrafshimin dhe përshtatjen e terrenit. Dhe me një moment kur kem shku, ishim t’gjithë ajo bërthama nisëmtare, dhe pothuajë të gjithë ishim ish të dënuar. Dhe kishim pasë fat, për koicidencë që t’na dënonte kryesuesit e trupit gjykues t’a kem të njejtin gjyqtar, Ukë Muqën, që ishte i po të njejtin fshat. Dhe vinte, nuk jam i sigurt a Salihu apo dikush, na thotë, “Ukë Muqa po kërkon të takohet me ju, nëse ju e lejoni.” Dhe ne iu drejtumë, thamë, “Ne privatisht nuk kem pasë asgja me Ukë Muqën. Edhe atëhere ia kem ba t’qartë edhe sot ia bojmë t’qartë: angazhimi i jonë është në t’mirën e çlirimit t’vendit. Prandaj nëse ka arritë m’i kuptu gabimet e veta dhe donë t’rreshtohet n’anën tonë, n’anën e popullit, lirisht le t’vie dhe le ta jep kontibutin e vet.” Edhe erdhi, normalisht si i ndërjerë n’faj, që ish normale. Dhe ne e kem pranuar dhe kem bisedu me te, po kem vazhdu punën.

Po ashtu disa ditë me rradhë jemi taku, kem bisedu dhe kem nda edhe përgjegjësitë, rolet se kush. Njeriu ma adekuat për ne, për udhëheqjen e tubimit ka qenë Jashar Salih. Dhe Jashar Salih, s’bashku me Havën, kanë qenë n’udhëheqje. Ne të tjerët kemi qenë, jemi marrë me punët organizative, që ishte masë shumë e madhe, kishte policë jashtëzakonisht shumë, t’mobilizumë, kishte përpjekje maksimale për t’pengu pjesëmarrjen, që ishte e natyrshme. Por ishte e pamundur për t’pengu, sepse njerëzit vërshunë nga t’gjitha anët dhe gjenin rrugë dytësore. Dhe kanë arritë aty. Dhe aty pastaj, madhështia ka arritë kur asht’ shtri dora e pajtimit, kur drejtpërsëdrejti nga masa janë lajmëru njerëz edhe vullnetarisht, që s’kishim pasë mundësi t’shkonim m’i vizitu, me kërku shtrirjen e dorës t’pajtimit, dhe kanë ardhë vullnetarisht e kanë shtri dorën e pajtimit. Dhe i kanë dhanë vërtetë atë fuqinë atij tubimi, dhe e kanë fuqizu Lëvizjen tonë për pajtim.

Pas atij tubimi, pastaj kem pasë tendenca të arrestimit. Jem detyru me Myrvete Dreshajn dhe une, u ngarkumë me detyrë me shku në pjesën nën Maqedoni. Kishim ni tubim, përveç që ishin mbajtë tubime në Tetovë, Kërçovë, e vendbanime të ndryshme, në komunën e Gostivarit, Këshillet e Pajtimit na ftunë. Edhe ne donim që t’shmangeshim pak nga territori i Kosovës se kishim ra tashma n’sy. Dhe kem shku në Çegran t’Gostivarit, është mbajtë ni tubim madhështor, ku janë ba ni numër shumë i madh i pajtimeve. Dhe momentin e fundit kanë tentu t’na arrestojnë, dhe ne i kem diktu duke iu falenderu shokëve tonë që

vepronin n'kuadër t'Këshillëve t'Pajtimimit. Dhe n'momentin e fundit na kanë tërheqë dhe na kanë masku edhe me veshje. Dhe i kem shpëtu edhe ketij arrestimi. Po ashtu Këshillet e Pajtimimit kanë vepru pastaj edhe në shumë shtete të perëndimit, deri në Amerikë, ku kanë dhanë ni kontribut jashtëzakonisht të madh.

Gjatë organizimit të tubimeve t'pajtimimit pas ni kohe ne kem pasë edhe kërcënim për arrestim, për t'na pengu. Po ajo çka është shumë me rëndësi të theksohet për mosndaljen e aktivitetit tonë, edhe përderisa disa kanë fillu të na shmangen, profesor Antoni dhe profesor Zekeriai, nuk na janë nda asnjëherë. Me profesor Zekerijanë tek tubimi i Verrave t'Llukës, meqenëse na kishin mësy autoblanda, polici, numër shumë i madh, dhe tentunë të hynë edhe në turmë me autoblandë, m'kujtohet kur kemi dalë s'bashku me disa djemë, ka qenë Xhemajl Fetahu, dhe jemi gjindë para autoblandës. Por n'mes tonin ka ardhë dhe s'na u ka nda asnjëherë profesor Zekeria Cana. Dhe t'gjithëve kjo pjesa ballore e tankut, e autoblandës, është ndalë në trupat tona. Dhe ne ishim t'vendosur mos të tërhiqemi pa shkelë mbi trupat tona. Dhe aty profesor Zekerijai ka reagu n'mënyrën ma t'ashpër t'mundshme dhe shumë të drejtë. Pastaj ne iu kem ba thirrje masës që t'qetësohen dhe iu kem shmangë ni katastrofe që ka mund të shndërrohet, dhe t'ketë vrasje jashtëzakonisht shumë.

Profesor Antoni dhe profesor Zekerija, kanë meritat ma të mëdha në masovizimin e Lëvizjes së Pajtimimit të Gjaqeve. Kanë qenë njerëz që thjesht, nëse mund t'themë, kanë qenë të shkrirë deri n'fund s'bashku me ne. Kanë qenë t'gatshëm çdo sacrificë t'a ndajnë s'bashku me ne. Në shumicën e rasteve profesor Antoni na është drejtu edhe me fjalë, se ne kem pasë ni rregull tjetër: që asnjëri nga ne nuk kem leju që t'marrim përgjegjësinë se, "E kem ba ne!" Dhe ni moment kur na ndëgjon profesor Antoni gjatë prononcimeve tona para gazetarëve, se është rinia dhe nuk u identifikojshim me emër, na pytë, tha, "Pse," tha, "nuk..." thamë, "Profesor, kjo është një lëvizje studentore, lëvizje e rinisë. Dhe ne nuk po dumë t'i nxisim ndjenjat e askujt, dhe askush mos ta ndinë veten ma pameritor se tjetri. Të gjithë jemi meritore. Qëllimi jonë i vetëm është suksesi. Prandaj nëse ne identifikohemi tash edhe rrahim gjyks se ne jemi ata që kem fillu këtë iniciativë, atëherë ne do t'shkaktojmë pakënaqësi, dhe shumë vështirë do ta kishim atë mbështetje dhe atë atmosferë që e kishim".

Dhe profesor Antoni na foli edhe për rolin pastaj të individit. Thamë, "Ne t'kemi ty." Tha, "Unë jam në moshë. Ky vend ka nevojë për fytyra t'reja, për personalitete t'reja." Thamë, "Ka kohë kur do t'dalin profesor." Profesor Antoni jo niherë, po është ndër t'rallët që në vazhdimësi edhe Zekeriai, edhe Antoni, janë edhe disa të tjerë, po kryesisht profesor Antoni, n'çdo takim, n'çdo fjalë t'vetën e ka potencu edhe ka thanë decedivisht se, "Une ndihem shumë i lumtur që jam n'mesin e rinisë. Kjo nisëm asht' nisëm e rinisë studentore nga Peja, e t'burgosurve politikë," e ka saktësu shumë qartë, "dhe ne jemi të gjithë përkrahës." Dhe kjo ka ndiku pastaj, që na i ka qetësu edhe shpirtërat, po edhe na ka dhanë forcë, jo vetëm ne, po t'gjithë rinisë studentore dhe qytetarëve të Kosovës.

Me këto shprehje, me këtë çiltërsi të profesor Antonit kemi arritë që Lëvizjen tonë ta shndërrojmë në një lëvizje vërtetë gjithë popullore. Por kemi dëshmi të shumta edhe në tubimin n'Rugovë t'Pejës, ku e kem mbajtë ni tubim masiv, falje masive të gjaqeve, kur na i janë zanë rrugtë nga policia gjithandaj, profesor Zekeria Cana na ka marrë me makinën e tina, e ka drejtu vetë makinën dhe kemi shku s'bashku. Dhe si ka

përfillë fare as policëtë, asni rrezik, dhe kemi shku bashkarisht kemi mbërri në vendin e ngjarjes, pra ku mbahej tubimi.

Po kem edhe kujtime t' shumta me profesor Antonin. Zakonisht, ai e ka njoftë folklorin shumë mirë. Ka pasë batuta t' jashtëzakonshme. Por ne kemi qenë paksa ma t' rezervumë, ne grupi i Pejës. Shumë i lirë ka qenë me Këshillin e Pajtimimit t' Gjakovës. Dhe me një rast, shokët nga Gjakova thanë... e organizumë që t' rrimë një mbramje, pas tubimit që e kishim m' duket në Smolicë, dikun në rrethinë të Gjakovës, që ishte po ashtu ni tubim shumë masiv. Dhe Shefqet Vokshi, Miradije Muriqi, Sylejman Loka, shumë tjerë që ishin, Ilir Bytyçi, e shumë tjerë aktivisë thanë, "Ejani sonte dhe ju do ta shifni se sa mirë ne kalojmë me profesor Antonin. Se ju e njihni vetëm një rën anë të profesor Antonit." Po kur kemi shku atë natë, dhe nuk na ka vërejtë ne profesor Antoni, ku është ndi shumë i lirë edhe ka fillu shakatë, dhe me një moment ne, nuk ishim mësu t' a dëgjojmë ashtu t' shprehet profesor Antoni, kur kemi dalë dhe po qeshim ne, ka bo, "O bo bo, po këtu qenkenit ju?" Dhe u kriju ni atmosferë me t' vërtetë shumë edhe ma e afërt me profesor Antonin.

N' shumicën e rasteve bashkarisht me profesorin gjatë rrugës për në fshatra ma t' thella që kemi pasë rast, t' na shoqëroj profesor Antoni edhe disa herë t' shkojmë në t' njëjtën familje. Kemi familje që kemi shku deri në 72 herë për t' kërk shtrirjen e dorës t' pajtimimit, derisa është bindë dhe na e ka shtri dorën e pajtimimit. Edhe profesor Antoni nuk ndiente lodhje fare. Shumë herë gjatë rrugës, na për të kursy kohën, ushqim zakonisht e kemi pasë po ashtu rregull që t' kërkjojmë te familja që i kemi shtri dorën e pajtimimit. Dhe pastaj e merrshim ushqimin n' makinë dhe vazhdojmë tutje. Dhe dikur edhe profesor Antoni në tërësi u pajtu me këto rregulla tona, i pranoi. Dhe thoshte, "Unë po i pranoj me kënaqësi shumë t' madhe se po ndihem i ri sikurse ju." Prandaj përveç se ka qenë ni profesor, edukator shumë i mirë, ka qenë edhe ni shok, ni njeri që ka ditë të përshtatet me t' gjitha moshat.

Ka ndiku pastaj autoriteti i profesor Antonit, i Zekeria Canës dhe disa të tjerëve, që vërtetë edhe përfaqësuesit edhe mediat ndërkombëtare që kanë qenë të shumta në numër, që i kanë përcjellë aktivitetet tona. Se tashma kjo u ba ni Lëvizje shumë interesante, shumë masive. Dhe u interesonte të gjithëve se vërtetë çka po ndodhë. Por ne kishim tash me veti studiuesin ma t' madhin t' vendit, profesor Antonin aty. Kishim edhe historianin me veti, që ishte profesor Zekerija Cana. Kishim Muhamet Pirrakun, Mujë Rugovën, Agim Vincën. Shumë profesorë tjerë që vërtetë na ndihmonin t' iu jepim edhe informata të randësishme për t' i plasu edhe para botës. Dhe n' këtë formë vlerësoj që Lëvizja e Pajtimimit të Gjaqeve ka reflektu n' shumë segmente.

Po ashtu ajo që është shumë me rëndësi: me kalimin e kohës, ne kemi fillu pastaj, kur veç Lëvizja e Pajtimimit filloi të masivizohej, se fillimisht kanë qenë shumë të domosdoshëm njerëzit ma t' besueshëm, si Xhemajli, Skender Çeku, shumë tjerë, dhe kemi fillu pastaj t' mendojmë për ni organizim t' ri. Se gjatë kohës t' Lëvizjes t' Pajtimimit t' Gjaqeve, gjatë ditës ne kemi hasë në pengesa, po n' orët e mbramjes na kemi lëvizë shpërthim. Edhe pse ni kohë u shpallë si orë policore, megjithatë ne kemi lëvizë, dhe s' kemi hasë askund pastaj në polici. Dhe e quanim se nata është e jona, dita është e policisë. Dhe preferonim lëvizjet ma tepër nga një vend në vendin tjetër edhe natën. Por filloi të ndihej nevoja për tu ngritë në një shkallë ma të lartë të

organizimit. Edhe n'bisëdë me Lëvizjen, se n'fund t'fundit Lëvizja Popullore Shqiptare ka qëndru prapa nesh dhe ne kem qenë t'gjithë pjesë e Lëvizjes Popullore.

Erëmirë Krasniqi: Cilat janë vitet e pajtimit mandej?

Adem Grabovci: Po viti i pajtimit, ne e kem shpallë kështu, me vendim tonin, “Viti '90 do të jetë vit i pajtimit”. Dhe në përfundim të vitit '90, ne pastaj kem parapa veprime të tjera. Që ne duhet ta mbajmë këtë mobilizim të masës. Dhe një veprim tjetër për ta mbajtur dhe për ta unifikuar, dhe për ta lidhur popullin tonë, për t'krijuar ura t'reja t'miqësisë, t'bashkëpunimit, t'njohjes. Kem gjetë edhe një formë tjetër të solidaritetit, se ne e dimë që t'90-tën pastaj u mbyllën të gjitha institucionet tona. Dhe kem aplikuar metodën, një aksion t'ri që është qujtë, “Familja ndihmon familjen”. Qëllimi ishte që t'krijohen ura të bashkëpunimit, ura të njohjes, miqësi të reja, që ato do t'na shërbenin, dhe na kanë shërby pastaj ma vonë shumë. Një familje e Pejës ka pasë për obligim ta ndihmojë në familje t'Shalës t'Bajgorës po e zëmë, dikun n'rrethina t'Mitrovicës. Ose ata të Mitrovicës në familje të Pejës. Dhe kështu t'gjitha komunitetet e Pejës dhe vendbanimet i kemi lidhur me njëri tjetrin. Dhe janë krijuar ura të bashkëpunimit, dhe ne kemi arritur sukseshëm me mbajtje t'zgjurmë atë mobilizim të masës, atë unitet.

Pastaj veprimi i dytë që ka qenë shumë mirë i menduar: identifikimi i disa njerëzve të cilët kanë qenë të gatshëm për veprime të matutjeshme, për veprimin e fundit. Se ma shifej se nuk do t'ketë alternativë tjetër pa luftë të armatosur. Dhe ne e kemi cilësuar organizimin e rojeve nëpër fshatra. Ne e kemi menduar atëherë që ta kemi në mekanizëm rekrutues po e quajë kushtimisht, që ato pastaj të shndërrohen edhe në njësi, apo grupe të armatosura. Dhe një nga djemtë që ka qenë drejtpërsëdrejti i ngarkuar me këtë detyrë, ka qenë dëshmorin i kombit Xhemajl Fetahi, [i cili] ka pasë mbështetjen prej Skender Çekut.

Ka qenë Isa Balaj dhe disa djemë tjerë të komunës së Pejës. Dhe këta kanë pasë pastaj të drejtë të rekrutojnë dhe të formojnë grupet n'koordinim të përbashkët. Kemi mbajtur disa takime në... zakonisht e kemi pasë në fshat që e kemi pasë shumë të sigurtë, në Radac të Pejës. Zakonisht e kemi shfrytëzuar mejtepin, që quhet në vend ku shfrytëzohet për t'gjithë, pra hoxha na e krijonte atë mundësi. Por edhe odat e familjes Bajraktari, Gjuraj, disa familje tjera, Elezajt, që na kanë pritur dhe aty kemi mbajtur disa takime, ku edhe kemi pasë biseda ma t'veçanta, me grupe ma t'veçanta, ku kemi biseduar edhe për formën e organizimit të rojeve, që si detyrë fillestare e kanë pasë identifikimin e lëvizjes nëpër fshatra.

Po me kalimin e kohës, aty normalisht tashmë kjo ishte rreziku ma i madh që shifte Serbia. Duhet t'punohej në fshatësi shumë t'madhe. Dhe masë pak kohe, shumica e këtyne djemëve janë rreziku, si Xhemajl Fetahi, dhe aty ka filluar pastaj ndjekja kundër nesh. Xhemajli u detyru t'kalojë në arrati. Pastaj u detyru edhe Hava të arratiset. Ka qenë fundi i vitit '90-të, fillimi i '91-tës, ku një pjesë shumë e madhe veç jemi detyru që të arratiset. Ku edhe vetë jam detyru pastaj të arratisem në perëndim. Qëllimi ka qenë edhe atje të... kemi mbajtur disa tubime fillimisht, me profesor Antonin, Zekerijanë, Murat Bejtën. Mujë Rugovën, në Gjermani, Zvicër, Austri, Francë. Po na është pamundësu disave kthimi në Kosovë, ku jemi detyru pastaj të kërkojmë strehim. Unë kam kërku strehim në Zvicër, dhe të tjerët.

Erëmirë Krasniqi: Sa kohë keni qëndru në Zvicër?

Adem Grabovci: Në Zvicër kam qëndru dikun rreth shtatë vjet, apo tetë, kështu me marrë vit kalendarik. Po qëndrimi im në Zvicër ka qenë i kohë pas kohëshëm, se lëvizjet kanë qenë t'vazhdueshme Zvicër-Kosovë. Po për dallim prej ma herët, kur kom ardhë, kom ardhë me dokumenta tjera, dokumenta t'huaja. Dhe kom ardhë thjesht n'mënyrë të fshehtë. Kom kry detyrat që m'janë ngarku nga organizata, nga Lëvizja Popullore në Zvicër. Dhe jam rikthy prapë në perëndim, ku kemi ndiku kur ka qenë e nevojshme të japim kontributin tonë mrena, për organizim të rradhëve të Lëvizjes. Po ashtu edhe për përgatitjen që na pritshke.

Se n'kuadër të Lëvizjes kanë vepru edhe sektorë të veçantë. Lëvizja në vazhdimësi ka bo përpjekje dhe ka mendu që një ditë duhet detyrimisht... mjeti i fundit do të jetë lufta e armatosur. Prandaj në vazhdimësi është mendu në këtë drejtim. Vazhdimisht ka sjellë armatim në Kosovë. Nji nga ata njerëz që ka kry këtë detyrë me përkushtim shumë të madh ka qenë Skender Çeku.

Lëvizja e Pajtimimit të Gjaqeve ka fillu në rrethana të jashtëzakonshme: në protesta. Për t'mbajtë frymën gjallë t'mobilizimit, ne kem gjetë ni mjet, e kem mendu, ma t'drejtë, sa human, aq edhe patriotik. Nëse e shohim nga këndvështrimi human, s'ka send ma humane, ma njerëzore, se sa me shpëtu jetna të njerëzve. Pra, m'i pajtu gjaqet, me ndërpre vëllavrasjen. Patriotike, s'ka ma patriotike nga këndvështrimi patriotik se sa tu i shpëtu jetrat e njerëzve dhe m'i mobilizu ata, m'i përgatitë për sfidat që na presin, pra për luftën e armatosur. Kjo ka qenë motoja e jonë: shtrirja e dorës t'pajtimimit, jo vetëm qëllim final me qenë luftimi i kësaj dukurie, po qëllimi jonë final ka qenë përgatitja për luftë të armatosur.

Së dyti, moto kryesore, kem marrë vendim se viti 1990, gjegjësisht fundi i vitit '89, nëntor-dhjetor kur kem fillu, dhe përfundimi i vitit 1990 të jetë vit i pajtimimit të gjaqeve. Nuk do të veproj ky Këshill pas përfundimit të këtij mandati. Ka fillu, fati ka deshtë në odën time në Pejë, në periferi. Pjesëmarrës, apo inicues kanë qenë Ibrahim Dreshaj, Have Shala, Lulëzim Etemaj, Myrvete Dreshaj. Ka qenë mysafir tek une po ashtu Flamur Gashi, Serbeze Vokshi. Ka qenë Bajram Kurti që na ka dhanë ni ndihmesë t'jashtëzakonshme, automjetet e tina, makinat, i kem pasë në dispozicion, edhe të vëllezërve. Dhe vëllaun që e ka pasë polic na ka ndihmu shumë n'çdo aspekt. Pastaj ka qenë pjesëmarrës edhe mbesa ime Lulja, qe ka qenë ni aktiviste shumë e devotshme, që ajo ka punu kryesisht me Lulëzimin, me Myrveten, Ibrahimin, dhe të tjerët.

Por ka qenë edhe vëllau im, tash i ndjerë, që na ka dhanë ni mbështetje t'fuqishme edhe morale. Se ka pasë ni përvojë edhe në traditën e odës, e ka njoftë relativisht mirë. Dhe me nji moment na drejtohet, thotë, "Ecni guximshëm, se qëllimin që e keni, do të jeni të suksesshëm." Edhe në ni moment tha, "Juve iu nevojiten edhe mjete, para. Unë nuk kam ma tepër për momentin, po e kam fondin rezervë të familjes." N'atë kohë kanë qenë ni mijë e pesë qind marka qe na i ka vu në dispozicion. Dhe pothuaj se janë gati se t'vetmet, duke i falenderu edhe bashkatdhetartë nga Suedia, nëpërmes Nasim Haradinajt që na i kanë dërgu ni sasi. Dhe kryesisht shpenzimet tjera i kem ba mbi baza vullnetare. Dhe ky vit ka qenë vit i pajtimimit. Fundi i 1990 ka qenë përfundimi i këtij aksioni. Vendimi ka qenë për arsye se "Ne nuk do t'lejojmë shtrirjen e dorës së pajtimimit aty ku do të ketë vrasje të re. Se nëse ne vazhdojmë si mekanizëm, ne do të shndërrohemi pastaj në nxitës të vëllavrasjes. Pra, e kem përfundu. Se njerëzit do t'mendojnë se ekziston tash ni mekanizëm, Këshilli i Pajtimimit, ne do t'mund ta vrasim njëri tjetrin, dhe na pajtojnë. Jo!"

Por ne kem gjetë pastaj forma tjera siç thashë, edhe “Familja ndihmon familjen”. Ka qenë pastaj Reshat Nurboja, e ka pasë ni ide që e kem mbështetë të gjithë, Jahja LLuka. Edhe solidarizimin me përkthimin e t’shpërngulurve që janë bo pastaj, janë regjistru disa vullnetarë në nivel t’vendit që kanë dhuru troje për ata që duan të kthehen, qoftë nga Turqia, qoftë nga shtetet tjera. Edhe ajo ka qenë ni solidaritet që ka ndiku shumë pozitivisht. Gjatë kësaj periudhe, po ashtu kemi organizimin ma t’lartë që asht’ mendu në organizim ushtarak, që është emërtu “Rojet e Fshatit”, por fatkeqësisht kjo ide pastaj është marrë nga të tjerët pasi jemi rreziku bërthama, njerëzit kompetent dhe është deformat.

Po ashtu gjatë aksionit t’pajtimit t’gjaqeve kemi edhe ni aksion shumë t’randësishëm, mobilizimin për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, pra 2 korrikun, ku në koordinim s’bashku me zotin Rugova n’atë kohë, dhe n’koordinim me deputetët e Parlamentit t’Kosovës atëherë, kem koordinu me Muhamet Bicin, m’kujtohet me Et’hem Çekun kur kem shku kem bisedu, kem bisedu me Adem Mikullovcin, me disa deputetë dhe kem bisedu me Ibrahim Rugovën. Na janë kërku ni numër i nënshkrimeve, që ishte si referendum. Dhe ne e kem shfrytëzu këtë mekanizëm tonin të organizimit që ishte në nivel të çdo vendbanimi, jo vetëm t’komunës, jo vetëm t’fshatit, po edhe në lagje. Dhe n’afat rekord, ne kem grumbullu mbi tetë qind mijë nënshkrime që ia kem çu deputetëve t’kuvendit. Që ishte referendum, që ishte një mundësi për t’iu kriju deputetëve, me u thirrë në vullnetin e qytetarëve, se të gjithë janë për shpalljen e pavarësisë. Dhe kjo ka ndodhë.

E kem elaboru idenë tonë para presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, dhe kjo ka ndodhë në shtëpinë e tij. Se fillimisht ne me Ibrahim Rugovën jemi taku pothuajë edhe dy herë apo tri herë gjatë javës, gjatë pajtimit të gjaqeve. Dhe Këshillet e Pajtimit kanë ndiku në formimin dhe masovizimin e Lidhjes Demokratike t’Kosovës. Se gjithë ato Këshille që i kem pasë ne t’pajtimit t’gjaqeve nëpër komuna, nëpër fshatra, nëpër lagje, janë shndërru pastaj në strukturë të organizime t’Lidhjes Demokratike të Kosovës. Dhe t’gjithë pa përjashtim kanë dhanë kontributin e vetë dhe kanë fuqizu. Se Lidhjen Demokratike n’atë kohë, ne e kem pasë si ni front të përbashkët. Dhe e kem shfrytëzu besoj në mënyrë të mrekullueshme. Dhe kjo ka qenë arsyeja që ne jemi taku vazhdimisht me presidentin Rugova.

Pastaj kanë qenë aktivistë që kanë marrë detyra konkrete. Janë zgjedhë kryetarë në rrafshin e Dukagjinit, po edhe n’nivel t’vendit, si Shaban Mani që ka qenë ni aktivist i dallumë edhe n’pajtimin e gjaqeve. Ni njeri i organizumë edhe në Ilegale. Ka qenë Ramë Berisha po ashtu që ka vepru n’Istog. Aktivist i dallumë, shumë i guximshëm, edhe n’kohën e Ilegales, se kom pasë kontakte të drejtpërdrejta, poro edhe në pajtimin e gjaqeve që nuk kanë kursy asgja nga vetja e vetë. Ka qenë Nezir Gashi, ka qenë Mustafë Ademi doktori, Riza Krasniqi, e shumë, e shumë, e shumë tjerë që vërtetë kanë ndiku. Dhe takimet tona me kryetarin e Lidhjes Demokratike t’atëherëshme, Ibrahim Rugovën, fillimisht jem taku në selinë e Lidhjes Demokratike. Po me kalimin e kohës, ne na ka sygjëru të takohemi në vende të veçanta, që n’disa raste jemi taku edhe në familjen e tij, në banesën e tij në Lakrishtë ku e ka pasë.

Takimi ma i randësishëm për mu ka qenë kur ne kem shku me idenë për shpalljen e pavarësisë. E kem elaboru, ka qenë Hava Shala, ka qenë Et’hem Çeku, ka qenë Ibrahim, nëse s’gabaj edhe Myrvetja ka qenë, t’pestit, dhe e kem elaboru si ide, se si ne e mendojmë. Ne mendonim që kuvendarët e asaj kohe, si të zgjedhur kushtimisht të popullit, të thirren në nënshkrime, në një formë referendum, të shpallin

pavarësinë. Ne ishim t'vetëdijshëm se masat, normalisht se policia nuk do të rrinte, pushteti duar kryq. Do të intervenonte policia, por ne ishim t'gatshëm. Pra Lëvizja Popullore që ishte organizim ilegal i asaj kohe, t'i vinte në ndihmë, dhe populli, dhe studentët ma së shumtë, deputetëve për t'i mbrojtë. Dhe ne kishim parapa pastaj që policisë do t'i vie në ndihmë edhe ushtria. Dhe në ni moment na ka pytë zoti Rugova, tha, "Çka do të ndodhë atëherë?" "Po normalisht se do t'ketë vrasje, do të ketë edhe arrestime. Kush do ta ketë fatin, po kjo asht' çmimi për liri." Dhe për ni moment asht' stepë edhe është nalë të mendoj.

Por megjithate, ne i dimë rrjedhat që kanë shku. Me këte dua të them, Lëvizja e Pajtitimit të Gjaqeve nuk ka qenë ni Lëvizje thjesht e pajtitimit, po ka qenë ni Lëvizje, ni mobilizim i përgjithshëm, që ka reflektu n'mënyrë të përgjithshme dhe të shumanëshme. Pas përfundimit të aksionit t'pajtitimit, ne jemi detyru m'u largu jashtë. Pas largimit jashtë, unë kam dalë me bindjen që dhe përcaktimin e qartë, "Nuk do të qëndroj në perëndim." Sepse unë edhe kur kam qenë i burgosun kom pasë ni ofertë edhe nga vetë policia që t'iki, t'arratisem, po e kom pa t'nevojshme dhe t'domosdoshme qëndrimin në Kosovë. Po pas largimit gjithnji e kom pasë andrrën, sikur gjithë të tjerët që të rikthehem në Kosovë.

Nuk e kom pasë ndërmend të organizohem, t'bëjë jetë t'organizume në perëndim, po me ni moment të caktuar, n'ato rrethana tu i pasë parasysh, Lëvizja në perëndim në përgjithësi, e them me theks t'veçantë në Zvicër ka qenë shumë e shkapërderdhur. Ishte fillimi i lindjes së pluralizmit, formimi i Lidhjes Demokratike dhe partive të tjera, që zëri i Lëvizjes atakohej pastaj si forcë ekstreme, ideologjike, e tjera, tjera, që ishte ni çudi nga akuzat për nacionalizëm, irredentizëm, e tjera, antikomunizëm, nga vetë ato forca filloi Lëvizja, ajo që ishte nacionaliste, irredentiste, e tjera, antikomuniste, të quhej marksist-leniniste, e kështu me rradhë.

Megjithate, ka qenë organizatë e vetme, e fuqishmem, e orientuar drejt, që ka parapa kombinimin dhe përdorimin e t'gjitha mjeteve për ta arritë qëllimin. Në programin e Lëvizjes, përveç faktorit politik që kurrë nuk ka qenë i diskutueshëm, i është dhanë rëndësia ma e madhe, ka qenë edhe sektori i veçantë ushtarak. Dhe në vazhdimësi është thanë dhe ka qenë e paraparë se pa kombinimin e këtyre dy sektorëve ne nuk mund ta arrijmë lirinë, gjë që koha e dëshmoi.

Pas ni kohe t'qëndrimit në Zvicër, njëri nga shokët që kam qenë edhe n'burg me te, Bardhyl Mahmuti, është ardhë n'emër të Lëvizjes, degës jashtë vendit, ka kërku që të riaktivizohem në Lëvizje. Arsyet ishin t'mjaftueshme, po ashtu edhe m'i ka përmend edhe bisedat me Afrim Zhitinë, Fadil Vatën, e kështu me rradhë. Dhe unë kom pranë t'angazhohem. Në ditët në vijim që kanë pasu, në ni mbledhje të '91-tës, jam zgjedhë kryetar i degës së Lëvizjes Popullore për Zvicër dhe anëtar i kryesisë së Lëvizjes për diasporë. Dhe kom fillu aktivitetin tim, dhe vlerësoj se duke iu falenderu mirëkuptimit që kom pasë te kryesia e asaj kohe, që ka qenë nënkryetar Ali Ahmeti, sekretar ka qenë Agush Buja, ka qenë Bardhyl Mahmuti, e shumë të tjerë. Pastaj ka qenë Jashar Salih, me t'cilët kemi arritë suksesshëm ta ringjallim aktivitetin e Lëvizjes Popullore, s'pari në Zvicër, por që ka reflektu në të gjithë diasporën.

Këta e ka ba edhe ni fakt, që edhe Jashari dhe une, po ashtu kemi qenë emra që kishim kontribu në Lëvizjen e Pajtitimit. Të identifikumë edhe si nisëmtarë dhe udhëheqës të Lëvizjes së Pajtitimit, kishim autoritet dhe kishim mbështetje te masa e gjerë dhe kishin besim tek ne. Dhe kem fillu masovizimin e

Lëvizjes. Me kalimin e kohës jam ngarku me detyrë për formimin e një fondi për përkujdesjen e familjeve të t'burgosurve, që ka qenë thjesht në maskim i fondit për luftën. Po ma vonë, jam ngarku me detyrë, po ashtu nga Lëvizja në sektorin, kanë qenë dy sektorë shumë të randësishëm: sektori politik, lidhje mbajtje brenda vendit, me Kosovën, dhe sektori i veçantë që e kem qujtë në atë kohë, apo ushtarak. Dhe natyra e sektorit ku isha, i lidhje mbajtjes, m'ka detyru detyrimisht, m'ka taku fati që shpesh herë të vie në Kosovë ilegalisht.

Edhe gjatë asaj kohe kam pasë takime, edhe me ish-presidentin Rugova, edhe me shumë personalitete tjera që jemi njoftë gjatë pajtimit të gjaqeve. Dhe detyrat që m'janë ngarku nga organizata pa hezitim i kam pranuar, pavarësisht prej rreziqeve, se t'futesh brenda ilegalisht në ato rrethana sa ka qenë pushteti serb ende në Kosovë, ka qenë, është e vetkuptueshme përgjegjësia dhe rreziqet. Po i kom marrë mbi vete ato dhe kom kalu suksesshëm. Disa herë, po fillimisht para fillimit të luftës, do të thotë unë kom dalë në Zvicër dikun në fund 1990-tës, në fillim të '91-tës. Fillimisht kom dalë vetëm, pastaj ka ardhë edhe bashkëshortja pas pak muje. Dhe unë jam kthyer në Kosovë me detyrë për herë të parë ku ilegalisht, me dokumenta që mi ka sjellë Skender Çeku. Ai ka mbajtur një linjë të autobusit Zvicër, Cyrih-Prishtinë, në bashkëpunim me djalin e axhës, Xhaferin. Dhe e kanë transportu qoftë literaturën nga perëndimi që ia ngarkojshim në Cyrih të Zvicrës, qoftë edhe armatim. Dhe kanë ndodhë disa herë të arrestohen, edhe Xhaferi, Gëzim Avdimetaj, dhe kanë përjetu tortura çnjerëzore. Po megjithatë, ata i kanë kalu.

Dhe unë herën e parë e kom pasë udhëtimin ilegal me Skender Çekun, që kem kalu pa ndonjë problem. Kem mbërri, kam krye ato detyrat që m'ishin ngarku. Pra kom marrë ato kontaktet e njerëzve që ishin të pajtimit dhe disa ma t'veçantë që kanë qenë të gatshëm të kontribuojnë në Lëvizjen Popullore të Kosovës. Kem diskutu për shumë hapa normalisht, dhe jam rikthyer. Herën e dytë kom ardhë nga Shqipëria, po ashtu m' duket ka qenë fundi i '91-tës, ku nga Shqipëria... në Shqipëri jam taku me Sami Kurteshin, ish-avokatin e popullit, në shok të burgut, dhe ma ka përgatitë pasaportën e vëllaut t'vetë. Me pasaportën e tij jemi hy nga Maqedonia. Por ishte interesant se kur kem shku në kufij kah Dibra, se Samiu e njipte atë pjesë, ka qenë edhe Kastriot Rexha, dibran, ish i burgosur, dhe ai na ka pritë.

Kur kem shku, kish qenë kufini tu u zgjeru, dhe kishin qenë punëtorë aty. Samiu tha, "Po shkojmë në doganë, drejt te policia me pasaportë." Thashë, "Mirë Sami, ti shko, po unë po ia mbajë këndeje, po bana inxhinier." se aty kishte punëtorë. E tash unë fillova me lujtë rolin e punëtorit aty, kishe po i kontrollon punimet, dhe dalëngadalë tu i përcjellë reagimet e policisë dhe e pashë se nuk po m'vërejnë. Po kur u fut Samiu te ata, ai edhe frikën se çka po më ndodhë mu, Samiun e nalën në polici edhe e majtën bukur shumë, tu e verifiku, tu e diskutu. Po mu m'u krijë tani mundësia shumë e mirë, edhe dola e kalova në kambë kufinin shpesh. Dhe pasi kalu, fillova me e ngucë Samiun, po edhe ai normalisht m'ngacmonte mu, tha, "Me kon jam? A je i tyne, a?" (qeshet) "Po," thashë, "shteti është i joni".

Dhe kem vazhdu me Samiun tek familja e Kastriot Haxhi-Rexhës. Prej aty kemi shku në Kumanovë, kem kalu në Preshevë, Bujanovc m' duket. Kem marrë autobusin për Prishtinë. Dhe kur jem futë në autobus, gjatë atij udhëtimi, t'njejtë udhëtim, unë jam ulë me në polici. Samiu u ulë në anën tjetër, edhe kishe po lexon gazetën. Po edhe unë ia mora atij policit, dhe hina në muhabet me ta, serb. Edhe po vazhdojmë

rrugën. Po gjatë rrugës kanë hy policia, t'vetmin që nuk më kanë kontrollu kam qenë unë, sepse une isha me policin.

Ndërsa herën e tretë kur jam futë, kom qenë me Ramadan Avdiun, m'ka marrë. Kom ardhë prej Zvicrës me ni shok t'Zvicrës, Shadanën Avdiun, me makinën e tij, nëpërmes të Tetovës. N'Tetovë na ka pritë Ramadani, kish rregullu dokumentat, me dokumenta t'huaja kalumë kufinin. Dhe me ni post bllok s'kishin kah, na nalën policia dhe unë normalisht tash ia dhashë pasaportën, edhe shumë i pajtumë tash me fatin. Po Ramadanit i ndodhi problem se e nxorrën nga makina, e bastisën, sa verifikimet ia banë, dhe n'këtë rast une shpëtova pa ndonji problem, dhe arritëm në Kosovë. Pastaj kom vazhdu për Pejë dhe në qendrat ku duhej.

Dhe ma vonë pastaj kem vazhdu jetën, po ashtu aktivitetet në Zvicër. Kemi ardhë pas kësaj vizite që quhej inspektim i gjendjes bazë në terren, s'bashku me Ramadanin dhe të tjerë, konstatumë se asht' e domosdoshme t'kem ni takim të përbashkët Lëvizja brenda vendit dhe Lëvizja jashtë vendit. Dhe kem përcaktu si vendtakim Kërçovën, fshatin Kollare, ku është mbajtë takim, përfaqësustë e Lëvizjes jashtë vendit, në oden, në shtëpinë e një shoku që ka qenë nga Kërçova, po ia harroj emrin për momentin. Aty janë taku, kanë ardhë përfaqësustë, apo delegatët nëse mund t'i qujmë të Lëvizjes nga Kosova dhe vendet tjera, viset nën Jugosllavi që ishin n'atë kohë, dhe kemi ardhë nga t'gjitha shtetet e perëndimit. Dhe aty i kem zgjedhë organet e përbashkëta, ku është debatue gjerë e gjatë. Dhe pothujë është takimi i parë që është marrë vendim për zgjedhje dhe organizim t'Lëvizjes gjithandej, edhe n'Kosovë, edhe n'diasporë.

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vit?

Adem Grabovci: N'vitin '92-93, nëse m'kujtohet, nëse s'gabohem. Mund t'i verifikojmë këto data.

Por aty është pastaj edhe vendimi për kalim në organizim ushtarak. Që këtu lirisht mund t'them që zen fill edhe fillimi i organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që i jep një formë edhe organizative. Dhe pas kësaj, kem mbajtë takimin në Zvicër kur kanë fillu edhe aksionet e para të armatosura. Dhe asht' komunikata e parë që asht' lëshu, ku edhe asht' marrë vendim që t'gjitha grupet e armatosura të kenë ni organizim, dhe t'jetë Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Erëmirë Krasniqi: Pse po thuni të gjitha grupet e armatosura?

Adem Grabovci: Po ka pasë njësite që kanë vepru n'kuadër t'Lëvizjes, po ma n'fund është pa e domosdoshme që sektori ushtarak, që ka vepru thashë n'kuadër t'Lëvizjes, që ka qenë edhe mrenda vendit. Ne si sektor politik, kemi pasë rolin tonë të organizojmë, t'mbajmë kontakte dhe lidhje me pjesën politike. Ndërsa sektori i veçantë, sektori ushtarak, që ka qenë n'kye me Azem Sylën, Xhavit Halitin, Ali Ahmetin. Në sektorin politik kemi qenë Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, ne t'tre. Dhe ne kemi pasë për detyrë, se kur është paraqitë, kemi pasë kontakte me djemë të cilët kanë kërku që të organizohen, ushtarakë, i takojnë sektorit ushtarak, kanë prirje për atë fushë, ne i kemi orientu tek ky sektor. Ndërsa ata politikë, i kanë orientu tek ne. Do të thotë bashkëpunimi, ne kemi qenë ni trupë e përbashkët që ka vepru n'kuadër të Lëvizjes Popullore t'Kosovës.

Pastaj kem formu, e kem pa të domosdoshme formimin e fondit, do të thotë ushtria pa financë, pa armë, nuk mund të... dhe e kem pa të domosdoshme formimin e fondit në Vintertur të Zvicrës. Kemi ngarku Jashar Salih, Agush Buja, dhe une, ne t' tre, me themelu këtë fond. Dhe kem fillu pastaj masovizimin e tina në krejt diasporën. Dhe kështu ka fillu pastaj edhe sigurimi i mjeteve, sigurimi i armatimit, dhe i gjërave të nevojshme për njësitet që kanë vepru mrena vendit.

Deri ni moment t'caktumë, ku ka fillu tash me vepru Ushtria Çlirimtare, deri në ato momente kohë pas kohe kom lëvizë ilegalisht. Në '97-98-tën jom kthy ma gjatë në Kosovë. Po pas betejës në Prekaz përfundimisht jam kthy edhe iu kam bashkangjite Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë. Kom qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Jam zgjedhë, dhe si shef apo kryeshef i G1-shit, drejtorisë t'parë, ka qenë një nga drejtoritë kryesore, qe është përkujdesë për organizimin, strukturën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, deri në marrëveshjen e Rambujesë.

Me marrëveshjen e Rambujesë, aty pastaj është marrë vendim, është nënshkru marrëveshja. Kanë pasu, dihet, intervenimi i NATO-s, dhe përfundimi, apo çlirimi i vendit. Ka qenë një nga vendimet të formohet qeveria e Kosovës, që njihet Qeveria e Përkohshme. Jam zgjedhë ministër i financave i Qeverisë së Kosovës, dhe pastaj kem vazhdu për disa mujë, ka vepru si qeveri. Pas shpërndarjes së Qeverisë së Përkohshme...

Erëmirë Krasniqi: N'cilat vite?

Adem Grabovci: Ardhja e UNMIKU-t ka qenë 2000-tën, '89-2000 aty, n'atë periudhë, po '99, pas t'99-tës. Që ardhja e UNMIKU-t dhe ndërtimi i strukturës t'përbashkët, vendore dhe ndërkombëtare. Nga Partia Demokratike pastaj jam emëru si bashkdrejtusë i Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë, apo ni formë si ministër i Tregtisë dhe Industrisë. Po atëherë kanë qenë të njohur si departamente, organizimi n'kohën e UNMIK-t.

Pas skadimit të atij mandati kemi formu Partinë Demokratike, do t' thotë n'99-tën. Jam njëri ndër, kom pasë fat t'jem, edhe siç e vërejtët, t'themi kom dhanë kontribut në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konstituimin dhe organizimin e fondit, pastaj edhe t'jem ndër... një kontribut kom dhanë edhe për formimin e Partisë Demokratike të Kosovës, ku jam zgjedhë fillimisht sekretar i financave, që kom pasë ni strukturë t'organizume, apo mirë t'organizume, me t'gjithë sektorët që duhet t'i ketë. Duke iu falenderu bashkpunëtorëve që kom pasë fat gjatë tërë kohës t'më përcjellin, mendoj që kem arritë deri diku të jem të suksesshëm. Dhe tash si deputet, shef i grupit qe dy mandate, besoj se do të përfundojmë suksesshëm.